



KOMUNA E LIPJANIT

Republika e Kosovës / Republika e Kosovës / Republika e Kosovës
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo
MINISTRIA E INDUSTRIË, TREGTISË DHE INOVACIONIT / MINISTRIJA INDUSTRIJE, TRGOVINE I INOVACIJE / MINISTRY OF INDUSTRY, TRADE AND INNOVATION
AGJENCIA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE, AGJENCIA ZA REGISTRACIJU KUPNOSTI, REGISTAR
REGISTRATION AGENCY, GENERAL COMMUNAL AND BUSINESS REGISTRATION CENTRAL BUREAU

Njesia Org. Org. jedin. Org. Unit.	11	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	517
Nr. i faq. Br. str. No. pg.	2	Data: Datum: Date:	24.06/2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02 Ref.11
Datë: 24/06/2026

Në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, paragrafi 1, 2 dhe 5 të, si dhe nenit 65 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe nenit 11 paragrafi 5 dhe 8 dhe Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, lidhin këtë:

AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE KOSOVË NË MINISTRINË
INDUSTRIË, NDËRMARËSISË, TREGTISË DHE INOVACIONIT
dhe
KOMUNA e LIPJANIT

lidhin

MARRËVESHJE PËR TRANSFERIM TË PËRHERSHËM PËR INTERES TË
INSTITUCIONIT

Palët e Marrëveshjes

- I. Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) të cilën e përfaqëson Valmira Sejdiu, U.d. Drejtore Ekzekutive në ARBK, në njërën anë dhe
- II. Komuna e Lipjanit të cilën e përfaqëson z. Imri Ahmeti Kryetar i Komunës së Lipjanit

Neni 1

Objekt i kësaj marrëveshjeje është transferimi i përhershëm i nëpunës civil, znj. Fitore Buja, nga pozita "Zyrtare për Regjistrim të Bizneseve" në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim të Komunës së Lipjanit, në pozitën "Zyrtare për Procesimin e të Dhënave" në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.

Transferimi bëhet në interes të institucionit MINTI, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe me pëlqimin e shprehur paraprakisht nga nëpunësja civile.

Neni 2

Palët e marrëveshjes janë pajtuar që transferi dhe pagesa në ARBK të bëhet duke filluar nga data 01.07.2026 Të drejtat dhe obligimet e nëpunësit të transferuar realizohen në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 3

Komuna e Lipjanit merr përsipër që dosjen e nëpunëses të ia përcjell Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore pran MINTI.

Neni 4

Kjo marrëveshje është hartuar në tri (3) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje si dhe znj. Fitore Buja

Kjo marrëveshje hyn në fuqi datën e nënshkrimit.

Znj. Valmira B. Sejdiu

U.d. Drejtore Ekzekutive në ARBK



Z. Imri AHMETI

Kryetar i Komunës së Lipjanit





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPJAN			
PRANUAR NË: PRIMLJENO DANA:		08.06.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01-	016/01-	25670	



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Institutit për Edukim, Demokraci dhe Art – Edu De'Art

dhe

Komunës së Lipjanit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet Institutit për Edukim, Demokraci dhe Art – Edu De'Art dhe Komunës së Lipjanit, me qëllim të bashkëpunimit në kuadër të projektit për përfshirjen e qytetarëve në planifikimin dhe zhvillimin e hapësirave publike në Komunën e Lipjanit.



Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është krijimi i një kornize bashkëpunimi ndërmjet Edu De'Art dhe Komunës së Lipjanit për themelimin dhe funksionimin e një Forumi, të përbërë nga të rinjë artistë, arkitektë, dhe studiues të fushave sociale nga Komuna e Lipjanit me synim identifikimin, analizimin dhe propozimin e ndërhyrjeve artistike në hapësirat publike të Komunës së Lipjanit. Ky aktivitet përkrahet nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia.

Neni 2

Fusha e bashkëpunimit

Palët pajtohen të bashkëpunojnë në këto fusha:

1. Formimin e Forumit për Intervenime në Hapësira Publike (tash e tutje: Forumi) në Lipjan;
2. Organizimin e takimeve koordinuese dhe konsultative me qytetarë dhe aktorë lokalë;
3. Analizën e hapësirave publike dhe identifikimin e zonave me potencial për ndërhyrje;
4. Zhvillimin e 2–3 koncepteve gjithëpërfshirëse për ndërhyrje artistike dhe urbane në hapësira publike;
5. Hartimin e raportit final dhe planit të qëndrueshmërisë;
6. Avokimin për përfshirjen e modelit të forumit dhe rekomandimeve të tij në planifikimet komunale të ardhshme.

Neni 3

Përgjegjësitë e Institutit Edu De'Art

Edu De'Art merr përsipër:

1. Të koordinojë zbatimin e përgjithshëm të projektit;
2. Të hartojë termat e references dhe kontratat për anëtarët e forumit;



3. Të organizojë procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të forumit;
4. Të organizojë takimet e Forumit, punëtoritë dhe konsultimet me komunitetin;
5. Të realizojë analizën e hapësirave publike në bashkëpunim me anëtarët e forumit;
6. Të përgatisë konceptet e propozuara për ndërhyrje në hapësira publike;
7. Të dokumentojë gjithë procesin dhe të përgatisë raportin final;
8. Të ndajë me Komunën e Lipjanit gjetjet, rekomandimet dhe materialet përkatëse të projektit.

Neni 4

Përgjegjësitë e Komunës së Lipjanit

Komuna e Lipjanit merr përsipër:

1. Të caktojë një pikë kontakti për koordinim me Edu De'Art;
2. Sipas nevojës, të lehtësojë qasjen në informata relevante lidhur me hapësirat publike të qytetit;
3. Sipas nevojës, të mundësojë dhe lehtësojë koordinimin me drejtoritë komunale përkatëse;
4. Sipas mundësive, të marrë pjesë në takime konsultative të Forumit;
5. Të organizojë një dëgjim publik me qytetarë për hirë të prezantimit të të gjeturave të forumit;
6. Të shqyrtojë rekomandimet dhe konceptet e propozuara nga Forumi;
7. Të vlerësojë mundësinë e përfshirjes së rekomandimeve në planifikimet komunale dhe në planin e punës për kulturë, rini, hapësira publike ose zhvillim lokal;



8. Të vëjë në dispozicion hapësirat komunale për mbajtjen e 10 (dhjetë) takimeve të Forumit;
9. Të sigurojë që në fazën e intervistave, një zyrtar nga Drejtoria për Kulturë do të marrë pjesë në komisionin e përzgjedhjes së anëtarëve që do të jenë pjesë e Forumit;

Neni 5

Forumi

Forumi do të përbëhet nga 7 anëtarë të përzgjedhur përmes një procesi transparent. Forumi do të shërbejë si mekanizëm pjesëmarrës për mbledhjen e ideve, analizimin e nevojave lokale dhe hartimin e propozimeve për ndërhyrje në hapësira publike.

Forumi do të zhvillojë takime të rregullta gjatë periudhës së zbatimit të projektit, duke përfshirë diskutime, punëtori, vizita në terren dhe konsultime me qytetarë.

Neni 6

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe mbetet e vlefshme deri në përfundimin e aktiviteteve të projektit, përkatësisht deri në shkurt 2027, përveç nëse palët pajtohen ndryshe me shkrim.

Neni 7

Aspektet financiare

Kjo Marrëveshje nuk krijon detyrim financiar për Komunën e Lipjanit, përveç nëse një gjë e tillë përcaktohet me marrëveshje të veçantë me shkrim. Edu De'Art është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve të projektit sipas buxhetit të miratuar nga donatori duke përfshi:

- a) Pagesen për anëtarët e Forumit;
- b) Pagesën për materialet e nevojshme përgjatë punëtorive dhe mbledhjeve;
- c) Pagesën për ushqimet dhe pijet;
- d) Pagesën për trajneret dhe ekspertët e angazhuar;



Neni 8

Dokumentimi dhe transparenca

Palët pajtohen që aktivitetet e realizuara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje të dokumentohen përmes listave të pjesëmarrjes, procesverbaleve, fotografive, raporteve analitike, materialeve vizuale dhe raportit final të cilat lehtësohen nga Instituti Edu De'Art.

Edu De'Art do të ndajë me Komunën e Lipjanit dokumentet kryesore të projektit, ndërsa Komuna mund t'i përdorë ato për qëllime të planifikimit, informimit publik dhe zhvillimit lokal, duke respektuar autorësinë dhe burimin e materialeve.

Neni 9

Promovimi dhe komunikimi publik

Çdo komunikim publik lidhur me aktivitetet e përbashkëta do të koordinohet ndërmjet palëve. Palët pajtohen të përmendin bashkëpunimin institucional në materialet publike, publikime, njoftime dhe evente që lidhen me projektin.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet përmes komunikimit dhe konsultimit të ndërsjellë ndërmjet palëve.

Neni 11

Dispozitat përfundimtare

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet ose plotësohet vetëm me pajtimin me shkrim të të dyja palëve. Marrëveshja hartohet në dy kopje origjinale, nga një për secilën palë.



Nënshkruar në Lipjan, më: ____/____/ 2026

Për Komunën e Lipjanit

z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës



Për Institutin Edu De'Art

z. Besart Zhuja – Drejtor ekzekutiv





Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPËSTINA LIPJAN			
PRANUAR MË:		25.05.2026	
PRIMLJENË DANA:			
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01	400/01-	23585	



Humanity First
Serving Mankind

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

lidhur ndërmjet

Komunës së Lipjanit

dhe

Humanity First

Për shpërndarjen e produkteve të mishit për **50 familje** në nevojë të Komunës së Lipjanit në prag të festës së Kurban Bajramit

Lipjan, Maj 2026

Qëllimi

1. Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe Humanity First është furnizimi me produkte të mishit të cilat do t'u shpërndahen familjeve në nevojë dhe që jetojnë me asistencë sociale në Komunën e Lipjanit.

Lloji i donacionit

1. Gjithsej do të shpërndahen **50 pako**. Për çdo familje do të shpërndahet një pako me produkte të mishit. Një pako peshon **5kg** dhe përmban: 2kg mish tul, 1kg qebapa, 1kg qyfte dhe 1kg suxhuk. 1 Pako ka vlerë rreth **36 euro**.

Orari i implementimit të donacionit

1. Në pajtim me të dyja palët e lidhjes së këtij memorandum mirëkuptimi është caktuar që shpërndarja e pakove me produkte të mishit të bëhet **ditën e hënë, më datë: 25.05.2026, në orën 14:00**.

Komuna e Lipjanit zotohet për të ofruar mundësitë e mëposhtme:

1. Për komisionin prej tre anëtarësh që do të bëjnë përgatitjen e listës së **50 familjeve** në nevojë që janë pranuese të donacionit, do të caktojë një anëtar. Anëtari i caktuar

është: **Burim Aliu**.

2. Të jenë të përpiktë në respektim të orarit dhe datës së caktuar të shpërndarjes së pakove ushqimore;
3. Angazhon së paku një zyrtar social për të ndihmuar shpërndarjen e pakove në terren;
4. Monitoron shpërndarjen e pakove me produkte mishi dhe kujdeset të regjistrojë emrin dhe mbiemrin e përfituesit, numrin e anëtarëve të shtëpisë së përfituesit, numrin personal të përfituesit, vendbanimin dhe nënshkrimin e përfituesit.

Humanity First zotohet për të siguruar mundësitë e mëposhtme:

1. Për komisionin prej tre anëtarësh që do të bëjnë përgatitjen e listës së **50 familjeve** pranuese të donacionit që janë në nevojë dhe me asistencë sociale, do të caktojë një anëtar. Anëtari i caktuar është: **Besmir Yvejsi**.
2. Përmes ndërmarrjes private ETC siguron produktet e mishit;
3. Përmes ndërmarrjes private ETC siguron transportimin e produkteve të mishit me automjetet frigorifere që i mban të freskëta produktet e mishit gjatë transportimit dhe shpërndarjes;
4. Të jenë të përpiktë në respektim të orarit dhe datës së caktuar të shpërndarjes së pakove me produkte të mishit;
5. I përmbahet të gjitha zotimeve të marra përsipër në këtë marrëveshje.

Dispozita përfundimtare

1. Ky memorandum është nënshkruar në katër (4) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Hyrja në fuqi

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët, ndërkohë zbatimi i saj fillon me datë **25.05.2026, ora 14:00**.

Vendtakimi i fillimit të shpërndarjes së pakove me produkte të mishit është:

Stadiumi i qyteti "Sami Kelmendi", Lipjan.

Lipjan

Datë: 25.05.2026

Komuna e Lipjanit



Humanity First





Republika e Kosovës
Komuna Lipjan



Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionale Kompanija za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A. / d.d.
Nr. 12/05/45
Dt. 13.05.2026
Prishtinë-Prishtina
Shtojcë 3



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Lipjanit / Opština Obilic / Municipality of Lipjan
Kompania Regionale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A

PRANUAR MË:
PRIMLJENO DANA:

15.05.2026

NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01	843/04 -	22256	

MARRËVESHJE MBI DHËNIEN NË PRONËSI TË KAMIONIT DHE AUTOFSHISAVE

Ndërmjet këtyre palëve:

1. KOMUNA E LIPJANIT, (Në cilësi të Aksionarit të KRM "Pastrimi" Sh.A.) me adresë në Rrugën Shqipëria, Nr.28, 14000 Lipjan, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, në tekstin e mëtejme **Dhënësi** - dhe.

2. KOMPANIA RAJONALE PËR MBETURINA "PASTRIMI" SH.A, më tej "**Kompania**" me adresë në rrugën "Tahir Zajmi" Nr.5 në Prishtinë, përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv, z. Petrit Reçica si **Pranuesi** në anën tjetër.

Neni 1 Lënda e dhurimit

1. Lëndë e kësaj Marrëveshje është përcaktimi i kushteve dhe rregullave për dhënie në Pronësi të 1 (një) Kamioni dhe 2 (dy) Autofshisave, në pronësi të së cilave është Komuna e Lipjanit me specifikat si vijon:

Nr.	Marka	Tipi	Ngjyra	Viti prodhimit	Nr.Shasisë
1	VARIOPRESS 308 s/n o535620 Mercedes Benz-chassis	Atego 1524 L4x2	Bardhë	2022	W1T96702710568735
2	TIMAN 3330	712000 Suction swwper.kw24 Ccm:962	E kuqe e hirit	2023	712000x01x1110
3	TIMAN 3330	712000 Suction swwper.kw24 Ccm:962	E kuqe e hirit	2023	712000x01x1111

2. Makineritë sipas paragrafit të këtij neni do të shfrytëzohen vetëm për nevojat e Njesisë Operative së Lipjanit.



Republika e Kosovës
Komuna Lipjan



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Lipjanit / Opština Obilic / Municipality of Lipjan
Kompania Regjionale e Mbeturineve "Pastrimi" Sh.A

2. Në rast kontesti eventual kompetente do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 8 Ekzemplarët e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje është formuluar në katër kopje origjinale, ku secila pale do të ketë nga dy kopje origjinale.

Neni 9 Konfidencialiteti

Palët pranojnë të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni të ndjeshëm të marrë gjatë periudhës së kësaj kontrate dhe pas përfundimit të saj. Ky detyrim përfshin, por nuk kufizohet në, informacionin financiar, strategjitë e biznesit, dhe çdo informacion tjetër që mund të konsiderohet si konfidencial nga palët.

Neni 10 Dispozitat përfundimtare

Palët deklarojnë se e kanë lexuar plotësisht dhe e kanë kuptuar të gjithë tekstin e kësaj Marrëveshje. Me vetëdije të plotë dhe pa presion i pranojnë dhe zotohen se do t'i respektojnë të gjitha nenet, kushtet që parashihen në këtë kontratë.

PALËT KONTRATKTUESE

Dhënësi:

Kryetari i Komunës së Lipjanit

z. Imri Ahmeti



Pranuesi:

KRM "PASTRIMI" Sh.A

z. Petrit Reçica



Komuna e Lipjanit

Adresa: Rr. Shqipëria nr: 28

14000 Lipjan, Kosovë

Tel: 0 800 14 000

Email: infokomuna.lipjan@rks-gov.net

Nr. ref: 01-016/01-21966

			
KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPJAN			
DËRGUAR MË: POSLATO DANA:		14.05.2026	
NJESIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LENDES ED. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01-016/01-21966			

14.05.2026

Destinacioni:

**Asociacioni i Komunave të Kosovës
(AKM)**

"Gustav Mayer" Nr. 6, Prishtinë 10000

info@komunat-ks.net

Lënda: Letër Mbështetjeje për Aplikim — Thirrje për Propozime**Ref:** EuropeAid/186350/DD/ACT/XK | Lot 1: Diversity, Equality and Inclusion

I/E nderuar,

Komuna e Lipjanit shpreh mbështetjen e saj të plotë institucionale për aplikimin e AKK-së Lead Applicant në thirrjen për propozime me referencë **EuropeAid/186350/DD/ACT/XK**, financuar nga Bashkimi Europian, me fokus në forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe institucioneve lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të gjithë qytetarët.

Qasjen e AKK-se nëpërmjet Kolegjiumeve tematike si mekanizëm pune, konkretisht Kolegjiumi për Komunitete, Kolegjiumi për Barazi Gjinore, Kolegjiumi për Zhvillim Ekonomik Lokal, Kolegjiumit për shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Kolegjiumi për Kulturë të cilat ofrojnë një platformë institucionale të provuar për ndarjen e praktikave më të mira dhe bashkërendimin e pozitive ndërkomunale ndaj qeverisë qendrore. Ky model i punës në bashkëpunim ndërkomunal, bazuar në mekanizma ekzistues, është pikërisht qasja e duhur për ndryshime të qëndrueshme.

Komuna e Lipjanit konfirmon gatishmërinë e saj për të marrë pjesë si komunë pilot në kuadër të projektit të propozuar, duke u angazhuar konkretisht në:

- Pjesëmarrjen aktive të zyrtarëve komunalë relevant në aktivitetet e trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve të organizuara nga AKK dhe partnerët e tij;
- Angazhimin e zyrtarëve komunalë në seancat e shkëmbimit të praktikave më të mira (peer exchange) nëpërmjet Kolegjiumeve të AKK-së;
- Bashkëpunimin në procesin e zhvillimit dhe validimit të standardeve minimale të qeverisjes gjithëpërfshirëse komunale;
- Vënien në dispozicion të hapësirave komunale (salla mbledhjesh, zyra) si kontribut institucional in-kind për aktivitetet e projektit;
- Integrimin e standardeve dhe protokolleve të miratuara në funksionimin e rregullt komunal pas miratimit nga Kolegjiumet e AKK-së;
- Raportimin periodik mbi treguesit e monitorimit të dakorduar, si pjesë e sistemit të ndjekjes së projektit.


Komuna jonë beson se qasja e propozuar e ndërtuar mbi arkitekturën institucionale ekzistuese të AKM-it dhe jo mbi struktura të reja garanton ndikimin afatgjatë edhe pas përfundimit të projektit. Standardet dhe mekanizmat e miratuara nëpërmjet Kolegjiumeve do të bëhen pjesë organike e funksionimit të rregullt komunal, pa varësi të vazhdueshme nga financimi i jashtëm.

Komuna e Lipjanit shpreh mbështetjen e plotë institucionale për AKM-in dhe partnerët e tij në këtë aplikim dhe konfirmon gatishmërinë për bashkëpunim aktiv gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Me respekt të lartë,

Nënshkrimi i autorizuar:

Vula zyrtare e komunës:


Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës / Mayor

Komuna e Lipjanit

Data: 14.05.2026





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË, TREGTISË DHE INOVACIONIT
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA, TRGOVINE I INOVACIJA
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP, TRADE AND INNOVATION

Njësia Org. 01 Nr. Prot. 1989
Org. Jedinica Org. Unit Prot. No.
Nr. faqeve 5/1 Data: 29. 4. 2026
Broj stranica No pages Datum:

PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN

PRANUAR MË:
PRIMLJENO DANA: 29.04.2026

JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJÇA PRILOG
01	400	01	19809



Komuna e Lipjanit
Municipality of Lipjan
Opština Lipjan

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija
Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and Innovation

Prishtinë, 29/04/2026

Duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-208 për Parqe Industriale dhe Teknologjike, Shtojcën 12 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, lidhet kjo:

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “ “NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS FIZIKE NË PARKUN INDUSTRIAL NË KOMUNËN E LIPJANIT, FAZA E V-të”

Palët nënshkruese

1. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, e përfaqësuar nga Ministria (në tekstin e mëtejme Ministria) dhe
2. Komuna e Lipjanit e përfaqësuar nga Kryetari (në tekstin e mëtejme Komuna).

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është përkrahja financiare e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, për realizimin e projektit “Ndërtimi i infrastrukturës fizike në Parkun Industrial në Komunën e Lipjanit, Faza e V-të”, si dhe përcaktimi i obligimeve të Ministrisë dhe Komunës për realizimin e këtij projekti..

Neni 2 Financimi i projektit

1. Ministria do të financojë projektin “Ndërtimin e infrastrukturës fizike në Parkun Industrial në Lipjan, faza e V” brenda kufijve buxhetor të paraparë nga ndarjet buxhetore, të përcaktuara

sipas Ligjit vjetor mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH).

2. Vlera e parashikuar e investimit për ndërtimin e infrastrukturës fizike të këtij parku, faza e V-të sipas raportit të pranuar nga komuna e Lipjanit, është 2,672,554.61 Euro për realizimin e tërësishëm të kontratës. Kjo vlerë mund të pësojë ndryshime varësisht prej elementeve përbërëse të projektit, dhe planifikohet të realizohet gjatë vitit buxhetor 2026 dhe 2027.
3. Vlera e saktë përfundimtare e investimit të projektit për ndërtimin e infrastrukturës fizike për Parkun Industrial në Lipjan, do të përcaktohet më kontratën ndërmjet Ministrisë dhe operatorit ekonomik të përzgjedhur konform procedurave të legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Përgjegjësitë e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit

1. Ministria udhëheqë dhe realizon procedurat për realizimin e projektit dhe do të nënshkruaj kontratën në pajtim me legjislacionin përkatës të prokurimit publik. Mjetet e parapara në Nenin 2 do të ndahen nga Ministria vetëm për shpenzimet e realizimit të kontratës, konkretisht për punët e aprovuara nga mbikëqyrësi i projektit dhe menaxheri i projektit të përcaktuar konform vendimit të Ministrisë.
2. Pagesat do t'i bëhen operatorit ekonomik konform kontratës.
3. Pagesat bëhen për aktivitetet e përfunduara në bazë të situacioneve të paraqitura nga operatori ekonomik të vërtetuara nga mbikëqyrësi i projektit dhe menaxheri i projektit të përcaktuar konform vendimit të Ministrisë.
4. Ministria më kërkesë të Komunës dhe në raste tjera, kur kjo është e domosdoshme do të i dërgojë Komunës këto të dhëna:
 - 6.1 Kopjet e kontratës;
 - 6.2 Kopjet e raporteve të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së punimeve;
 - 6.3 Detajet e pagesave të bëra sipas kontratës dhe
 - 6.4 Dokumente dhe raporte tjera sipas nevojës.

Neni 4

Përgjegjësitë e Komunës së Lipjanit

1. Komuna me vendim do të përcaktojë zyrtarin përgjegjës për koordinim me Ministrinë me qëllim të mbarëvajtjes së punimeve në teren.
2. Rregullimi i marrëdhënieve pronësore-juridike dhe sigurimi i punishtes për realizimin e punimeve, janë në përgjegjësinë e Komunës.
3. Komuna mbanë përgjegjësinë për hartimin e projektit, duke përfshirë përlllogaritjen e paramasës, realizimin e matjeve dhe elementet e tjera teknike, si dhe për sigurimin e funksionalitetit të plotë të projektit. Gjithashtu, Komuna duhet të inkorporojë integrimin e elementeve të gjelbra dhe zbatimin e praktikave të ekonomisë qarkore.

4. Pas përfundimit të kontratës dhe pranimi teknik të saj, infrastruktura fizike do të menaxhohet nga Komuna e Lipjanit, e cila mbanë përgjegjësi për mirëmbajtjen, ruajtjen e investimeve, sigurimit të hapësirave dhe përmbushjen e obligimeve komunale, në pajtim me Ligjin nr.08/L-208 për parqet Industriale dhe teknologjike si dhe aktet nënligjore të cilat burojnë nga ky Ligj.

Neni 5

Përgjegjësitë dhe zotimet e përbashkëta

1. Ministria ka autoritetin dhe përgjegjësinë për lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik të përzgjedhur, sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, si dhe caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit, të cilët janë përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të projektit.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i caktuar nga Ministria si dhe zyrtari përgjegjës i caktuar nga Komuna për monitorim të punimeve, kanë përgjegjësi të plotë të ndërhyjnë dhe të kërkojnë marrjen e masave përkatëse në rast se konstatojnë se punimet nuk jrealizohen në përputhje me kontratën.
3. Mbikëqyrësi, menaxheri si dhe zyrtari përgjegjës raportojnë tek autoritetet përkatëse nga të cilat janë caktuar, në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre institucionale dhe ligjore.
4. Destinimi sektorial i Parkut Industrial dhe modeli i menaxhimit përcaktohen me vendim të Ministrisë, duke u bazuar në prioritetet strategjike zhvillimore dhe analizat ekonomike përkatëse.
5. Ministria dhe Komuna zotohen të bashkëpunojnë që, gjatë procesit të zhvillimit të projektit të Parkut Industrial, të promovohen dhe zbatohen parimet e ekonomisë qarkore, përfshirë përdorimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme, trajtimin e ujërave të ndotura, klasifikimin dhe riciklimin e mbetjeve, si dhe krijimin dhe ruajtjen e hapësirave të gjelbra.
6. Ministria dhe Komuna zotohen që zhvillimi dhe funksionimi i Parkut Industrial të udhëhiqet nga parimet e gjithëpërfshirjes dhe mundësive të barabarta, duke siguruar qasje të barabartë për të gjitha komunitetet. Në këtë kuadër, do të promovohet edhe fuqizimi ekonomik i grave dhe mbështetja e pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet ekonomike që zhvillohen brenda Parkut Industrial.

Neni 6

Shqetësimet shtesë të ngritura nga palët

1. Palët ndajnë shqetësimin e përbashkët lidhur me keqpërdorimet e mundshme, të cilat mund të çenojnë parimet e qeverisjes së mirë, përdorimin e drejtë dhe efikas të burimeve publike, si dhe zhvillimin dhe konkurrencën e drejtë dhe të hapur, të bazuar në çmim dhe cilësi.
2. Palët zotohen se për cdo dyshim apo konstatim për keqpërdorim të mundshëm, do të bëjnë një njoftim zyrtar tek autoritetet kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të bëjnë përpjekje për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që mund të kenë ndërmjet veti, përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore.

Neni 8
Pronësia e projektit

1. Deri në momentin e pranimin të pasurisë jo financiare organizata buxhetore financuese (Ministria) do të regjistrojë transaksionin në kategorinë e “investimeve në vijim”, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi, për menaxhimin financiar dhe të pasurisë publike.

2. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar procedurat e dorëzimit, përfshirë pranimin teknik dhe ekzekutimin e pagesës përfundimtare sipas kontratës, organizata buxhetore financuese, në këtë rast Ministria, do të mbyllë llogarinë e “investimeve në vijim”.

3. Organizata buxhetore pranuese, në këtë rast Komuna e Lipjanit, pasurinë jo financiare të pranuar nga Ministria, obligohet t'a regjistrojë në regjistrat e saj të pasurisë jo financiare, në përputhje me Rregullorja MF-nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare.

Neni 9
Amendamentet

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e dyanshëm të nënshkruesve të marrëveshjes.

Neni 10
Përfundimi

Palët mund të shkëpusin marrëveshjen me akt të njëanshëm duke dhënë 30 (tridhjetë) ditë afat me njoftim paraprak (arsyetim), në formë të shkruar palës tjetër.

Neni 11
Kopjet e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje është hartuar në katër (4) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga dy (2) kopje.

Neni 12
Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje, shfuqizohet marrëveshja e datës 28.08.2024, me numër protokollit 4211/01.
2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Mimoza KUSARI LILA

Ministre në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë,
Tregtisë dhe Inovacionit



Imri AHMETI

Kryetari i Komunës së Lipjanit





AMANDAMENT (I) I MARRËVESHJES

për bashkëfinancim në projektin për Zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në Ndërtesën Shumë Banesore Sociale I- Magure, në mes të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Komunës së Lipjanit.

Ky amandament bëhet me qëllim të ndryshimit të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit nr. protokoli (FKEE) 2080/24 të datës 12.11.2024, e lidhur ndërmjet Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) dhe Komunës së Lipjanit, si vijon:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
MARRËVESHJE
PRANUAR MË:
SHILJENI DANA: 27.04.2026
NR. KLASIFIKIMIT
NR. LËNDËS
NR. KLASIFIKACIJE
NR. PREDMETA
SHTOJCA
PRIOLOG
01-352/02-19340

Palët:

- Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)**, përfaqësuar nga znj. Njomza Hoxha, në cilësinë e Drejtores Menaxhuese të FKEE-së.
- Komuna Lipjanit** përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Lipjanit.

Duke marrë parasysh:

- nevojën për të saktësuar vlerat përfundimtare të projektit referuar Marrëveshjes për Bashkëfinancim, si pasojë e ndryshimeve të konstatuara në vlerën fillestare të projektit, të cilat kanë rezultuar nga përfundimi i plotë i punimeve dhe nga rishikimi përfundimtar i investimit, në përputhje me kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën e punëve;

Palët bien dakord për ndryshimet në vijim:

Neni 1

Ndryshohet pika 1.6.1, Neni 1, nga Marrëveshja bazë:

Shuma e bashkëfinancimit të projektit është 220,847.45 EUR (100%) nga të cilat:

- 198,762.71 EUR (90 %) financohet nga FKEE, dhe
- 22,084.75 (10%) financohet nga Komuna.

Neni 2

Ndryshohet tabela tek Shtojca 4 nga Marrëveshja e Bashkëfinancimit: Kontratat midis FKEE dhe Kontraktorëve për Shërbime të ndryshme dhe Punime.

Nr.	Kontrata/Fushëveprimi	Kontraktori	Vlera	Vlera 10%
-----	-----------------------	-------------	-------	-----------

	Auditimi i Energjisë, modelet teknike, mbikqyrja, komisionimi dhe periudha e DLP	Ndërtimi & Seaptum	13,400.00 €	1,340.00 €
	Punët për zbatimin e MEE	Grupi i Operatorëve Ekonomik IBM, SHPK Delta, SHPK Termomontimi, Mitrovicë, Ulqini, nr 223,40000, Mitovicë.	207,447.45 €	20,744.75 €
	Totali		220,847.45 €	22,084.75 €

Neni 3

Ndryshohet tabela tek Shtojca 6 nga Marrëveshja e Bashkëfinancimit: Detajet lidhur me pagesën e pjesës së bashkëfinancimit nga Komuna, në vlerë 10% të vlerës së përgjithshme të projektit.

Nr	Projekti	Vlera totale e projektit	Vlera e financimit nga FKEE – 90%	Vlera prej 10% e bashkëfinancimit nga Komuna
1	Zbatimin e Masave të Efiçencës së Energjisë në Ndërtesën Shumë-Banesore Sociale -I- Lipjan, Magure	220,847.45 €	198,762.71 €	22,084.75 €

Neni 4

Ekzekutimi i pagesës nga FKEE në llogarinë e Komunës

Vlera prej 1,268.25 Euro përfaqëson diferencën e vlerës së bashkëfinancimit prej 10% ndërmjet projektit fillestar dhe projektit të realizuar. Kjo shumë do t'i kthehet Komunës së Lipjanit përmes llogarisë së Thesarit nr. 1000400070000180, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e nënshkrimit të këtij Amandamenti.

Kthimi i kësaj difference bëhet duke marrë parasysh se Komuna, në fillim të realizimit të projektit, ka kryer pagesën e plotë të obligimit prej 10% në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëfinancimit.

Neni 5

Ndikimi në dispozitat tjera

5.1. Ky amendament nuk ndryshon ndonjë dispozitë tjetër të marrëveshjes bazë, përveç asaj që është specifikuar në këtë dokument.

5.2 Të gjitha dispozitat e tjera të marrëveshjes bazë mbeten në fuqi dhe janë të zbatueshme.

Neni 6

Fuqia ligjore e amendamentit

Ky amendament hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është pjesë integrale e Marrëveshjes për Bashkëfinancim në mes FKEE-së dhe Komunës së Lipjanit.

Palët:

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë




Njomza Hoxha
Drejtore Menaxhuëse e FKEE-së

Datë: 31.03.2026

Komuna e Lipjanit




Imri Ahmeti
Kryetari i Komunës së Lipjanit



Zotimet e Fondacionit:

- Fondacioni sipas planit mësimor, të siguron disa vende për trajnim profesional për kandidatët e propozuar zyrtarisht nga Komuna;
- Fondacioni siguron trajnim profesional pa pagesë dhe e lëshon çertifikatën me suksesin e kandidatëve.

Zotimet e Komunës:

- Komuna të dërgoj listën me emrat e kandidatëve të propozuar për trajnim profesional, duke cekur fushën e kërkuar të trajnimit;
- Komuna (sipas nevojës) të asistoj Kandidatët që regjistrohen në trajnim, me transportin apo me pagesën për transport gjatë tërë periudhës së kursit;
- Komuna të jap konsideratën për gratë dhe vajzat që përfundojnë trajnimin me sukses, prioritet që të përfitojn grantet apo makineri përkatese për të filluar biznesin e tyre.

II. AFATI DHE ZGJATJA

Ky Memorandum hyn në fuqi nga data e nënshkrimit 21 Prill 2026, dhe do të jetë i vlefshëm për një periudhë prej 12 Muajve, me mundësinë e rishikimit dhe rinovimit sipas dakordimit të palëve.

III. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky Memorandum nuk krijon asnjë detyrim ligjor ose financiar mes palëve, por shërben si bazë për bashkëpunim.
2. Palët bien dakord të respektojnë konfidencialitetin e të dhënave dhe informacioneve të ndara.

IV. NËNSHKRIMI

Në shenjë miratimi, palët nënshkruajnë Memorandumin si më poshtë:

Pala e Parë	Pala e Dytë
Fondacioni Sheikha Fatima bint Mubarak per Gruan	Komuna e Lipjanit
Drejtoresha Miradije Salihu	Kryetari i Komunës Imri Ahmeti
 	 





MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NDËRMJET

Fondacionit Sheikhha Fatima bint Mubarak për Gruan, NIU5200671-6, adresa: Rr. Nëna Terezë nr.84, Fushë Kosovë, e përfaqësuar nga Drejtoresha: Miradije Salihu, në vijim referuar si **"Pala e Parë"**.

DHE

Komuna	Lipjanit	Drejtorja	
Adresa	Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë	Telefoni	038/200-415-22
Email	imri.ahmeti@rks-gov.net		
Përfaqësuar nga	Imri Ahmeti	Pozita zyrtare	Kryetari i Komunës

në vijim referuar si **"Pala e Dytë"**.

I. QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Ky Memorandum synon të krijojë një kuadër bashkëpunimi ndërmjet palëve, duke u fokusuar në: Trajnim profesional të grave dhe vajzave nga mosha: 8/16 deri 55 vjeç, për kurset për aftësimin profesional, në fushat:

Kurs	Nga Mosha	Deri në moshën	Kohëzgjatja, Muaj
Rrobaqepës	16	55	4 muaj
Pasticeri	16	55	4 muaj
Grim	16	55	4 muaj
Parukeri	16	55	4 muaj
Manikyr	16	55	4 muaj
Pedikyr	16	55	4 muaj
Anglisht	8	55	4 muaj (1 Nivel)
Komputer 	8	55	4 muaj
Menaxhmenti i ndërmarrjeve të vogla	16	55	4 muaj



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNË E LIPJANIT OPË QNA LIPJAN			
PRANUAR MË:		01.04.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT DE KLASIFIKACIONE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PETOJA
01-	360/09-15302		



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Komuna
 Fushë Kosovë



Komuna
 Lipjan



Komuna
 Obiliq



Komuna
 Podujevë



Komuna
 Prishtinë

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

NË MES TË

KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS
 KOMUNËS SË LIPJANIT
 KOMUNËS SË OBILIQIT
 KOMUNËS SË PODUJEVËS
 KOMUNËS SË PRISHTINËS

DHE

QENDRËS PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE FËMIJËVE (QMGF) - PRISHTINË

5. Një grup i përbashkët pune me përfaqësues nga të gjitha komunat e përfshira do të përcaktojë kontributet për 2027 dhe 2028, jo më vonë se 20 janari i vitit respektiv. Këto vendime do të paraqiten në Shtojcën 1.

6. Nëse disa komuna vendosin ta rrisin kontributin e tyre me vetëdëshirë, kjo nuk do të ketë pasoja për obligimet e komunave tjera të përcaktuara në MM.

7. Fondet për kontributet do të alokohen nga kategoritë buxhetore Subvencione dhe Transfere dhe do të transferohen në llogarinë e strehimores në një pagesë të vetme, jo më vonë se data 31 janar e secilit vit fiskal.

Neni 3

Obligimet e strehimores

1. Strehimorja do të dorëzojë një kërkesë zyrtare për ndihmë financiare bashkë me Planin Vjetor Financiar dhe Operacional te komunat, jo më vonë se data 15 janar në vitin për të cilin ndihma kërkohet.
2. Strehimorja është e obliguar të dorëzojë një raport financiar tre (3) muajor bashkë me faturat përkatëse te komunat.
3. Strehimorja është e obliguar të dorëzojë një raport financiar vjetor jo më vonë se data 31 dhjetor. Raporti duhet të përmbajë një pasqyrë statistikore që tregon se sa viktima ka shërbyer strehimorja gjatë vitit dhe nga cilat komuna vijnë ato.
4. Në rast të mosrespektimit të ndonjërit nga paragrafet e nenit 3, komunat kanë të drejtë të mos kryejnë pagesat respektive deri sa të zbatohen obligimet.

Neni 4

Dispozitat përfundimtare

1. Kryetarët e komunave do të sigurojnë implementimin e plotë të këtij MM.
2. MM do të nënshkruhet në gjashtë (6) kopje origjinale dhe secila palë do të ketë një kopje.
3. MM hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
4. MM do të publikohet në uebfaqet e komunave.

Neni 5

1. Mosmarrëveshjet mes palëve do të zgjidhen me vullnetin e mirë të palëve.

Prishtinë, data: 31 mars 2026

Metodologjia për përcaktimin e kontributeve për komunat, për vitet 2027 dhe 2028

1. Shpenzimet vjetore të strehimores (sipas Planit Vjetor Financiar dhe Operacional)
2. Kontributet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
3. Shuma totale e kontributeve vjetore të komunave sipas MM: #1 - #2.
4. Përcaktimi/përlllogaritja e kostos së mirëmbajtjes së strehimores (sipas Planit Vjetor Financiar dhe Operacional)
5. Përlllogaritja e kontributeve komunale financiare individuale (Komponenta 1): #4 / 6
6. Përcaktimi/përlllogaritja e kostos së shërbimeve të ofruara nga ana e strehimores (sipas Planit Vjetor Financiar dhe Operacional)
7. Përcaktimi/përlllogaritja e ndarjes (në %) së viktimave nga secila komunë, në raport me numrin total të viktimave (sipas Raportit Vjetor Financiar).
8. Përlllogaritja e kontributeve komunale financiare individuale (Komponenta 2): #6 * #7.
9. Kontributi final vjetor për komunë: #5 + #8. (Komponenta 1 + 2)



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



planifikimit, organizimit dhe zbatimit të aktiviteteve, si dhe për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm ndërmjet palëve, me qëllim të sigurohet një bashkëpunim efikas dhe i rregullt gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

NENI 5 – PARIMET ETIKE

Pjesëmarrja në të gjitha aktivitetet e projektit është plotësisht vullnetare dhe bazohet në pëlqimin e informuar të pjesëmarrësve, si dhe, kur është e aplikueshme, në pajtimin prindëror për nxënësit nën moshën 18 vjeç. Të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë realizimit të projektit përdoren ekskluzivisht për qëllime hulumtuese, analitike dhe raportuese, dhe trajtohen në përputhje me parimet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Në asnjë fazë të projektit nuk do të publikohen apo shpërndahen informacione që mund të identifikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi pjesëmarrësit individualë.

NENI 6 – DISPOZITA FINANCIARE

Kjo marrëveshje nuk krijon obligime financiare për asnjërën palë.

NENI 7 – KOHËZGJATJA

Marrëveshja hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe mbetet e vlefshme për kohëzgjatjen e plotë të implementimit të projektit, respektivisht deri më **30 Dhjetor 2026**. Palët mund të bien dakord për vazhdimin, ndryshimin ose përfundimin e kësaj marrëveshjeje përpara afatit të saj, me njoftim paraprak me shkrim dhe në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë. Përfundimi i marrëveshjes nuk cenon obligimet që lidhen me konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave të mbledhura gjatë kohëzgjatjes së saj.

NENI 8 – DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Kjo marrëveshje hartohet në formë të shkruar dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët. Çdo ndryshim, plotësim apo interpretim i kësaj marrëveshjeje bëhet vetëm me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim ndërmjet palëve dhe hyn në fuqi pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar.

PALET NËNSHKRUESE

Mentor Vrajolli,
Drejtor Ekzekтив

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Rasim Hasani,
Drejtor
Drejtoria Komunale e Arsimit
Komuna e Lipjanit



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENË DANA:		11.03.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
04-610/01-12020			



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ndërmjet

**QENDRËS KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (QKSS) E PËRFAQËSUAR NGA MENTOR VRAJOLLI,
DREJTORI EKZEKUTIV I ORGANIZATËS**

dhe

DREJTORISË SË ARSIMIT NË KOMUNËN E LIPJANIT E PËRFAQËSUAR NGA DREJTORI, Z. RASIM HASANI

NENI 1 – QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Kjo marrëveshje ka për qëllim të rregullojë dhe formalizojë bashkëpunimin ndërmjet Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në Lipjan në kuadër të implementimit të projektit të titulluar **"Brezi i rrezikuar: Trajtimi i kriminalitetit tek të rinjtë dhe sigurisë në shkolla përmes hulumtimit dhe reformimit të bazuar në evidenca"** i cili ka për qëllim të avokoj për fuqizimin e sigurisë nëpër shkolla dhe parandalimin e dhunës tek të rinjtë. Marrëveshja përcakton parimet e përgjithshme të bashkëpunimit, rolet dhe përgjegjësitë e palëve, si dhe kornizën etike dhe procedurale për realizimin e aktiviteteve hulumtuese, me qëllim të krijimit dhe forcimit të një mjedisi shkollor të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës për nxënësit, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

NENI 2 – FUSHA E BASHKËPUNIMIT

Bashkëpunimi ndërmjet palëve përfshin lehtësimin dhe mbështetjen e realizimit të aktiviteteve hulumtuese në kuadër të projektit, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në: zhvillimin e anketave anonime me nxënësit, organizimin e diskutimeve të strukturuar në grupe të vogla (focus groupe), si dhe realizimin e intervistave gjysmë-të-strukturuar me staf arsimor dhe aktorë relevantë institucionalë.

Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të koordinuar për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e këtyre aktiviteteve, duke siguruar që ato të zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, politikat institucionale përkatëse, si dhe standardet profesionale dhe etike të hulumtimit.

Të gjitha aktivitetet hulumtuese do të realizohen në ambient të sigurt dhe të përshtatshëm, në koordinim të plotë me përfaqësuesit e shkollës/institucionit, pa cenuar procesin mësimor dhe funksionimin normal të institucionit.

NENI 3 – DETYRIMET E QKSS

QKSS angazhohet të zbatojë projektin në mënyrë profesionale, etike dhe konfidenciale, duke siguruar pajtimin prindëror dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

NENI 4 – DETYRIMET E INSTITUCIONIT

Institucioni angazhohet të mbështesë realizimin e aktiviteteve hulumtuese në kuadër të projektit, në përputhje me kapacitetet dhe procedurat e tij të brendshme, si dhe të caktojë një person përgjegjës si pikë kontakti për koordinim dhe komunikim të vazhdueshëm me QKSS. Kjo pikë kontakti do të shërbejë për lehtësimin e



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANA:		04.03.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOB
01-	320/01-	10945	



Prishtinë, __/__/2026

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT “Farat e Fuqizimit: Gratë në Agrikulturë”

E lidhur ndërmjet

Fondacioni Jahjaga i përfaqësuar nga znj Egzona Bexheti, Drejtore Ekzekutive e Fondacionit Jahjaga (në tekstin e mëtejme Fondacioni),

dhe,

Komuna e Lipjanit, i përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z.Imri Ahmeti.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është bashkëfinancimi i projektit “Farat e Fuqizimit: Gratë në Agrikulturë”, si dhe përcaktimi i të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella ndërmjet Fondacionit Jahjaga dhe Komunës, në funksion të zbatimit të suksesshëm dhe realizimit të plotë të këtij projekti..

Neni 2 Vlera e projektit dhe mënyra e financimit

Projekti “Farat e Fuqizimit: Gratë në Agrikulturë” është duke u implementuar nga Fondacioni Jahjaga, me mbështetjen financiare të donatorit UNMIK. Vlera totale e projektit është 36,769.00 USD (tridhjetë e gjashtë mijë dollarë).

Neni 3 Obligimet e Fondacionit

1. Fondacioni ndërmerr të gjitha hapat e duhur për implementimin me sukses të projektit.
2. Fondacioni harton projektin e detajuar dhe kurikulat e programit të trajnimit për gratë
3. Fondacioni krijon grupin e ekspertëve (IADK) që ofrojnë trajnimin profesional.
4. Fondacioni cakton një menaxher të projektit i cili shërben si pikë kontaktuese me Komunën.



Neni 4 Obligimet e Komunës

1. Komuna e Lipjanit monitoron dhe mirëmban të dhënat e përfitueseve nga Komuna e Lipjanit, në kuadër të projektit.
2. Komuna e Lipjanit zotohet të ofrojë mbështetje financiare në formë subvencionimi dhe bashkëfinancimi për aktivitetet e projektit që kanë në fokus fuqizimin ekonomik të grave të Komunës së Lipjanit, në vlerë prej 500.00 EUR (pesëqind euro).
3. Komuna e Lipjanit cakton një zyrtar/e përgjegjës/e për monitorimin e implementimit të projektit, i/e cili/a do të monitorojë zbatimin e projektit dhe do të pranojë raportet e implementimit sipas kërkesës.

Neni 5

Përfitueset e Projektit

Në kuadër të këtij projekti për fuqizimin socio-ekonomik të grave, përfitueset janë shtatë (7) gra nga Komuna e Lipjanit, përkatësisht nga fshatrat në vijim:

- **Zymryte Goliqi** (Hallaq i Vogël) – posedon 3 ari tokë dhe merret me kultivimin e pemëve, perimeve dhe pastiqerisë.
- **Fatmire Grajqevci** (Ribar i Madh) – posedon 20 ari tokë, jeton në Torinë dhe ka një serë prej 50 m²; vitin e kaluar ka kultivuar kunguj në sipërfaqen e përmendur.
- **Besjana Kastrati** (Vërshëfc) – posedon një lopë qumështore, 10 ha tokë me misër dhe grurë, si dhe një mulli uji.
- **Hatixhe Lugolli** (Lleletiq, Magurë) – posedon 0.5 ha tokë bujqësore; nuk ka serë dhe as multikultivator për punimin e tokës.
- **Gyleferije Qeriqi** (Krojmir) – posedon tokë bujqësore në fshatin e saj dhe planifikon të fillojë prodhimin e pemëve dhe perimeve; aktualisht nuk ka serë.
- **Aurora Jashari** (Hallaq i Vogël) – merret me kultivimin e pulave dhe fazanëve dhe ka nevojë për inkubator.
- **Emine Osmani** (Vrellë) – merret me prodhimin e drithërave dhe punimin e tokës; posedon 1.5 ha tokë bujqësore dhe ka nevojë për pajisje shtesë.

Neni 6

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

Me pëlqimin paraprak të Drejtoreshës Ekzekutive dhe Kryetarit të Komunës, marrëveshja mund të ndryshohet, plotësohet apo ndërpritet.



Neni 7
Transferimi i mjeteve financiare

Transferimi i mjeteve financiare nga Komuna do të realizohet menjëherë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje nga palët në llogarinë bankare me nr: 1701001600101156 në NLB BANK, të Fondacionit Jahjaga.

Neni 8
Zgjidhja e marrëveshjes

Palët janë pajtuar në mes vete që kjo marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 9
Numri i kopjeve

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy kopje, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 10
Pronësia e projektit

Me pranim dorëzimin e shërbimeve dhe detyrimeve të palëve, pronësia e projektit do mbetet në kuadër të Fondacionit.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Marrëveshje e Mirëkuptimit fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Kryetari i Komunes

Imri Ahmeti



Fondacioni Jahjaga

Arlinda Zajmi





FARAT E FUQIZIMIT: GRATË NË AGRIKULTURË

Informacion i Përgjithshëm

Projekti “Farat e Fuqizimit: Gratë në Agrikulturë” fillon implementimin në tetor 2025 dhe përfundon në maj 2026. Ky projekt synon fuqizimin ekonomik të grave në fushën e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit, përmes trajnimeve teorike dhe praktike, si dhe përfitimit të pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së tyre bujqësore.

Projekti vjen si vazhdimësi dhe rezultat i suksesshëm i projektit “Fuqizimi i grave nga komunitetet e marginalizuara me aftësi sipërmarrjeje dhe profesionale – Faza II”, i implementuar në Komunën e Novobërdës, i cili ka treguar rezultate të jashtëzakonshme në fuqizimin socio-ekonomik të grave përfutuese.

Që nga tetori i vitit 2025, Fondacioni Jahjaga ka filluar implementimin e projektit “Farat e Fuqizimit: Gratë në Agrikulturë”, i financuar nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe i implementuar nga Fondacioni Jahjaga (JF). Projekti zbatohet në Komunën e Lipjanit dhe Graçanicës, duke përfshirë gjithsej katërmëdhjetë (14) përfutuese, prej të cilave 7 nga Lipjani dhe 7 nga Graçanica.

Përmbledhje e Projektit

Në kuadër të programit për fuqizimin socio-ekonomik të grave, **Fondacioni Jahjaga** po implementon një program për **ndërtimin e kapaciteteve në fushën e bujqësisë** për shtatë (7) gra nga Komuna e Lipjanit, përkatësisht nga fshatrat:

- **Zymryte Goliqi** (Hallaq i Vogël) – posedon 3 ari tokë dhe merret me kultivimin e pemëve, perimeve dhe pastiqerisë.
- **Fatmire Grajqevci** (Ribar i Madh) – posedon 20 ari tokë, jeton në Torinë dhe ka një serë prej 50 m²; vitin e kaluar ka kultivuar kunguj në sipërfaqen e përmendur.
- **Besjana Kastrati** (Vërshëfc) – posedon një lopë qumështore, 10 ha tokë me misër dhe grurë, si dhe një mulli uji.
- **Hatixhe Lugolli** (Lleletiq, Magurë) – posedon 0.5 ha tokë bujqësore; nuk ka serë dhe as multikultivator për punimin e tokës.
- **Gyleferije Qeriqi** (Krojmir) – posedon tokë bujqësore në fshatin e saj dhe planifikon të fillojë prodhimin e pemëve dhe perimeve; aktualisht nuk ka serë.
- **Aurora Jashari** (Hallaq i Vogël) – merret me kultivimin e pulave dhe fazanëve dhe ka nevojë për inkubator.



- **Emine Osmani (Vrellë)** – merret me prodhimin e drithërave dhe punimin e tokës; posedon 1.5 ha tokë bujqësore dhe ka nevojë për pajisje shtesë.

Me qëllim të realizimit të plotë të projektit, siç është diskutuar me **Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik**, Komuna është zotuar të ofrojë mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për pajisje shtesë, ose për rritjen e shumës së përcaktuar për pajisje përfitueseve, proporcionalisht, në vlerë prej **71.42 euro për secilën përfituese**.

Mbështetja e ofruar do të përbëjë një hap të rëndësishëm në fuqizimin e këtyre grave, duke u mundësuar atyre përfitimin e aftësive të reja profesionale dhe përmirësimin e ndjeshëm të mirëqenies së tyre ekonomike dhe sociale.

FAZA I: Ngritja e kapaciteteve përmes programit të trajnimit në fushën e bujqësisë (3 muaj)

Gjatë periudhës tremujore, përfitueset do të ndjekin një program trajnimi teorik dhe praktik, i krijuar dhe i përshtatur sipas nevojave dhe aftësive individuale të tyre, i realizuar nga **IADK**. Ky program do t'u mundësojë përfitueseve rritjen e njohurive profesionale dhe përmirësimin e aftësive praktike në bujqësi.

FAZA II: Blerja e pajisjeve

Përfitueset do të pajisen me pajisje të nevojshme për punimin e tokës dhe përpunimin e ushqimit, në përputhje me nevojat e tyre specifike dhe planin e projektit.

FAZA III: Pjesëmarrja në Panairin AGROKOS në Prishtinë

Përfitueset do të kenë mundësinë të marrin pjesë në **Panairin AGROKOS**, ku do të promovojnë produktet e tyre dhe do të krijojnë mundësi për rrjetëzim dhe qasje në treg.

FAZA IV: Mentorimi nga IADK

Pas përfundimit të trajnimeve dhe pajisjes me mjete pune, përfitueset do të përfitojnë mentorim të vazhdueshëm nga **IADK**, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë dhe zhvillimit afatgjatë të aktiviteteve të tyre bujqësore.

Koha dhe Vendodhja

Projekti synon fuqizimin e grave në **dy komuna: Lipjan dhe Graçanicë**. Implementimi i projektit do të zgjasë nga **tetori 2025 deri në maj 2026** dhe do të përfshijë programin e trajnimit, përfitimin e pajisjeve dhe pjesëmarrjen në **Panairin AGROKOS në maj 2026**.

Objektivat e Projektit

- Të fuqizojë ekonomikisht gratë nga Komunitet e Lipjanit dhe Graçanicës përmes përfshirjes aktive në sektorin e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit.
- Të rrisë kapacitetet profesionale të grave përfituese përmes trajnimeve teorike dhe praktike në bujqësi, të përshtatura sipas nevojave dhe potencialit të tyre individual.



- Të përmirësojë qasjen e grave në mjete dhe pajisje bujqësore, duke lehtësuar punën e tyre dhe duke rritur produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e aktiviteteve bujqësore.
- Të mbështesë gratë në zhvillimin e aktiviteteve të vogla bujqësore si burim i qëndrueshëm i të ardhurave për familjet e tyre.
- Të rrisë njohuritë dhe aftësitë e grave në përpunimin e ushqimit, duke respektuar standardet e higjienës dhe sigurisë ushqimore.
- Të forcojë lidhjen e grave përfituese me tregun përmes pjesëmarrjes në Panairin AGROKOS dhe aktiviteteve të tjera promovuese.
- Të ofrojë mentorim të vazhdueshëm profesional për gratë përfituese, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë afatgjatë të rezultateve të projektit.
- Të kontribuojë në përmirësimin e pozitës sociale të grave në komunitet, duke rritur rolin e tyre në vendimmarrje dhe zhvillim lokal.



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVSKA KATASTRARSKA AGENCIJA
Nr. Bc. 01/310/26
Nr.faq./Bc. 27-2-2026
Data/Datum: 27-2-2026
B. J. LIPJAN



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN



DËRGUAR MË:
POSILATO DANA: 04.03.2026
NJËSIA NR. KLASIFIKIMIT NR. LENDËS SHTOJCA
JEDINICA BR. KLASIFIKACIJE BR. PREDMETA PRILOG
01-015/02-10927

ANEKS MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT (MM)

Ndërmjet

AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

dhe

KOMUNËS SË LIPJANIT

për

KOMPLETIMITIN E SISTEMIT TË ADRESAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS

Ky aneks ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me numër të protokollit të AKK-së 01/1407/22 të datës 30.09.2022 dhe numër të protokollit të Komunës së Lipjanit 01/660/03-52813 të datës 30.09.2022.

Përgjegjësitë e palëve në MM mbeten të njëjta, përpos pikave të reja.

Palët janë pajtuar si më poshtë:

[Agjencia Kadastrale e Kosovës]

Tek përgjegjësitë e Agjencisë Kadastrale të Kosovës shtohet një pikë e re.

7. Agjencia Kadastrale e Kosovës zotohet se do ti mbuloj shpenzimet e pagës prej 25 % për një konsulent të angazhuar në projektin "Ndërlidhja e qytetarit me adresë" për periudhën 6 mujore (175 Euro bruto) për konsulent për një muaj, duke filluar nga data 01.03.2026.

[Komuna]

Tek përgjegjësitë e Komunës shtohet një pikë e re.

21. Komuna zotohet se do ti mbuloj shpenzimet e pagës prej 75 % për një konsulent të angazhuar nga AKK në projektin "Ndërlidhja e qytetarit me adresë" për periudhën 6 mujore në shumën (525 Euro bruto) për konsulent për një muaj, duke filluar nga data 01.03.2026.

Të gjitha palët do të kenë parasysh kufizimet kohore për kompletimin e Sistemit të Adresave.

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga të gjitha palët dhe është plotësisht në fuqi që nga ajo datë. Ai do të mbetet i vlefshëm deri në ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky mirëkuptim, përveç rastit kur ai përfundon më herët nga secila palë, duke i njoftuar palët e tjera jo më pak se një muaj me shkrim. Çdo modifikim i këtij Memorandumi të Mirëkuptimi do t'i nënshtrohet miratimit me shkrim të palëve.

Nënshkruar më datën _____ në Lipjan, në pesë kopje në gjuhën shqipe dhe angleze.

Për Komunën e Lipjanit

Kryetar i Komunës

z. Imri Ahmeti



Për Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Drejtor Ekzekutiv

z. Avni Ahmeti





Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA
Nr./Br. 01/310/26
Nr. fq./Br.str. 27-2-2026
Data/Datum: 27-2-2026
PRISHTINË-PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN

DËRGUAR ME:
POSLATO DANA: 04.03.2026

NJËSIA JEDINICA	NR. KLASHIFIKIMIT BR. KLASHIFIKACIJE	NR. LENDES BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
--------------------	---	----------------------------	-------------------

01-015/02-10927



ANNEX TO MEMORANDUM OF UNDERSTANDING (MoU)

between

KOSOVO CADASTRAL AGENCY

and

MUNICIPALITY OF OF LIPJAN

for

COMPLETION OF THE ADDRESS SYSTEM IN THE TERRITORY OF THE MUNICIPALITY

This Annex shall aim to amend and supplement the Memorandum of Understanding under the KCA protocol number 01/1407/22 dated 30.09.2022 and the Municipality of Lipjan protocol number 01/660/03-52813 dated 30.09.2022.

The responsibilities of the parties under the MM shall remain unchanged, except for the newly added points.

The Parties agree as follows:

[Kosovo Cadastral Agency]

A new point is added to the responsibilities of the Kosovo Cadastral Agency:

7. The Kosovo Cadastral Agency shall undertake to cover 25 % of the salary costs for a consultant engaged in the project "Interconnection of the citizen with an address" for a six (6) month period (€175 gross) per consultant per month, starting from 01.03.2026.

[Municipality]

A new point is added to the responsibilities:

21. The Municipality shall undertake to cover 75 % of the salary costs for a consultant engaged by the KCA in the project "Interconnection of the citizen with an address" for a 6-month period (€525 gross) per consultant per month, starting from 01.03.2026.

All parties shall take into account the time limits for the completion of the Address System.

This Memorandum of Understanding shall enter into force upon signature by all parties and shall be fully effective as of that date. It shall remain valid until the completion of the obligations arising from this MoU, unless terminated earlier by any party with written notice to the other parties not less than one month in advance. Any amendment to this Memorandum of Understanding shall be subject to the written approval by all parties.

Signed on _____ in Lipjan, in three copies in Albanian and English.

For Municipality of Lipjan

Mayor of the Municipality
Mr. Imri Ahmeti



For Kosovo Cadastral Agency

Executive Director
Mr. Avni Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

PRANUAR MË:
PRIMJENJO DANA: 25.02.2026

NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT SR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS SR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01	300/01	9828	

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Projekti: "E ARDHMJA E SAJ – Fuqizimi i Grave Sipërmarrëse në Kosovë"

i përfaqësuar nga
Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik - PREDA Plus Kosovë
dhe
WEntrepreneur

më tutje - Autoriteti Zbatues

dhe

Komuna e Lipjanit

më tutje - Komuna Partnere

(më tutje të referuara së bashku si "Palët")

Hyrje

Projekti: **“E ARDHMJIA E SAJ – Fuqizimi i Grave Sipërmarrëse në Kosovë”** është një projekt i financuar nga Ministria Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Projekti zbatohet nga organizata joqeveritare PREDA Plus, në partneritet me WEntrepreneur dhe me mbështetjen e Arbeiter Samariter Bund (ASB) Köln. Ky bashkëpunim ndërthur ekspertizën lokale me mbështetjen ndërkombëtare për të krijuar ndryshim të qëndrueshëm në ekonominë e grave.

Projekti ka filluar më 1 nëntor 2025 dhe do të zbatohet deri më 31 tetor 2028. Gjatë këtyre 36 muajve, iniciativa do të punojë në mënyrë sistematike për të ndërtuar një ekosistem më gjithëpërfshirës dhe mbështetës për bizneset e udhëhequra nga gratë në gjithë Kosovën.

Projekti synon fuqizimin e grave në Kosovë përmes zhvillimit të aftësive të tyre të biznesit, krijimit të rrjeteve mbështetëse dhe nxitjes së një mjedisi të favorshëm për pjesëmarrjen ekonomike të grave. Projekti fokusohet në planifikim strategjik, ngritje kapacitetesh dhe krijimin e hapësirave të dedikuara ku gratë sipërmarrëse mund të lidhen, të mësojnë dhe të rrisin bizneset e tyre, duke kontribuar kështu në barazinë gjinore dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Duke adresuar pengesat individuale dhe institucionale, projekti synon të çlirojë potencialin e madh të grave si motorr i rritjes ekonomike.

Neni 1. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi për Bashkëpunim (MB) është të sigurojë një kornizë për bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet palëve, duke përshkruar përgjegjësitë dhe angazhimin e ndërsjellë për të mirën e një zbatimi të suksesshëm të Projektit.

Neni 2. Fushat e Bashkëpunimit

Projekti: **“E ARDHMJIA E SAJ”** synon drejtpërdrejt **562** përfitues, përfshirë: gra sipërmarrëse ekzistuese dhe aspiruese, vajza të reja, si dhe përfaqësues nga institucionet qendrore dhe lokale, shoqëria civile dhe shoqatat e biznesit. Projekti do të sigurojë pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, me fokus të veçantë tek grupet e marginalizuara, përfshirë gratë nga zonat rurale dhe minoritetet etnike. Kjo qasje shumëpalëshe është thelbësore për ndërtimin e një sistemi mbështetës koheziv dhe të qëndrueshëm.

Projekti bazohet në pesë komponente kryesore që sigurojnë suksesin e tij:

Komponenti 1: Bashkëpunimi i palëve të interesit dhe kuadri politik

Ky komponent fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të aktorëve kyç për promovimin e ndërmarrësisë së grave. Si i tillë, përfshin krijimin e një Grupi Kombëtar të Koordinimit Strategjik dhe shtatë Grupeve Punuese Rajonale. Këto struktura do të punojnë së bashku për të integruar një “Masë Strategjike për Ndërmarrësinë e Grave” në Planet e Veprimit për Zhvillim Rajonal, duke siguruar që pjesëmarrja

ekonomike e grave të jetë prioritet në nivel politik. Kjo do të krijojë një bazë institucionale afatgjatë për mbështetjen e grave sipërmarrëse edhe pas përfundimit të projektit.

Komponenti 2: Ndërtimi i një Ekosistemi Bashkëpunues në të gjithë Kosovën për Gratë Sipërmarrëse

Ky komponent synon të krijojë dhe forcojë një rrjet të formalizuar kombëtar për gratë ndërmarrëse. Projekti do të mbështesë krijimin e shtatë Degëve Rajonale, duke u ofruar atyre kapacitete operacionale, trajnime dhe dukshmëri. Këto degë do të shërbejnë si qendra të decentralizuara për rrjetëzim, mentorim dhe avokim, duke fuqizuar gratë ndërmarrëse në të gjitha rajonet. Kjo qasje siguron që rrjeti të ndërtohet mbi nevojat reale dhe pronësinë e anëtareve, duke krijuar një sistem mbështetës të fuqishëm dhe të ndërlidhur.

Komponenti 3: Aftësimi dhe ofrimi i pajisjeve për 100 biznese të reja në pronësi të grave

Ky komponent ofron mbështetje gjithëpërfshirëse për gratë që dëshirojnë të fillojnë biznesin e tyre. Përfitueset do të marrin trajnime të personalizuar në planifikim dhe menaxhim biznesi, mentorim dhe pajisje esenciale për zhvillimin e biznesit. Qasja e integruar është dizajnuar për t'u mundësuar të paktën 100 grave të nisin dhe të mbajnë me sukses bizneset e tyre, duke përmirësuar gjendjen socio-ekonomike të familjeve të tyre. Paketat e mbështetjes do të përshtaten sipas ideve individuale të biznesit – nga shërbimet IT deri te rrobapëësia dhe konsulenca.

Komponenti 4: “Bootcamp-i” i Ndërmarrësisë për 350 vajza të reja

Përmes pesë serive të “bootcamp-eve” hibride (kampeve intensive të ndërmarrësisë) ky komponent do t'u ofrojë 350 vajzave të reja njohuri dhe aftësi thelbësore ndërmarrëse. Programi kombinon punëtori, mësim praktik dhe mentorim nga sipërmarrës të suksesshëm, me synimin për të ndërtuar vetëbesimin dhe për t'u dhënë pjesëmarrëseve mjetet praktike për të eksploruar vetëpunësimin dhe krijimin e bizneseve. Format i hibrid siguron pjesëmarrje të gjerë, duke lejuar edhe vajzat nga zonat e largëta të përfitojnë plotësisht.

Komponenti 5: Fuqizimi i kapaciteteve të partnerëve lokalë të projektit

Për të siguruar zbatimin e suksesshëm dhe qëndrueshmërinë e projektit, ky komponent fokusohet në forcimin e kapaciteteve teknike dhe strategjike të organizatave partnere lokale. Trajnimet do të përfshijnë fusha si planifikimi strategjik, menaxhimi i rrjeteve, zbatimi i projekteve me ndjeshmëri gjinore dhe avokimi – duke i aftësuar ata të promovojnë dhe mbështesin në mënyrë efektive ndërmarrësinë e grave në Kosovë. Forcimi i këtyre organizatave lokale siguron që ekspertiza dhe mbështetja për gratë sipërmarrëse të mbeten brenda vendit.

Neni 3. Përgjegjësitë e Autoritetit Zbatues

Në përputhje me komponentët dhe rezultatet e pritshme të përshkruara në Nenin 2, Autoriteti Zbatues do të sigurojë një zbatim të suksesshëm të të gjitha aktiviteteve duke:

- Ofrimin e ndihmës profesionale për përfituesit e Projektit dhe Komunitat Partnere;
- Aftësimin e përfituesve të Projektit në një nivel të kënaqshëm dhe në përputhje me standardet e parashikuara;
- Zbatimin e praktikave më të mira në zhvillimin e biznesit dhe mbështetjen e bizneseve fillestare;
- Zbatimin, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Projektit, të një niveli të lartë transparence dhe paanshmërie.

Neni 4. Përgjegjësitë e Komunitat Partnere

Komunitat Partnere do të sigurojë ekzistencën e një niveli dhe cilësie të mjaftueshme të informacioneve që do t'i ofrohen Autoritetit Zbatues, për nevojat e zbatimit të aktiviteteve të Projektit. Në raste kur paraqitet nevoja, Komunitat Partnere do të ofrojë personelin e saj në mënyrë që të ndihmojë në zbatim të suksesshëm të aktiviteteve të Projektit.

Neni 5. Natyra jo-kontraktuale e marrëdhënieve

Palët bien dakord që ky Memorandum përfaqëson mirëkuptimin e ndërsjellë dhe nuk është menduar dhe as nuk do të konsiderohet si kontratë dhe nuk do të krijojë asnjë të drejtë dhe detyrim sipas kontratës. Asgjë që përmbahet këtu nuk do të interpretohet në mënyrë që të përbëjë një partneritet sipërmarrjeje të përbashkët ose një organizatë formale biznesi të çfarëdo lloji ndërmjet Palëve ose në mënyrë që të përbëjë njëra Palë si agjent i tjetrit.

Palët pranojnë që ky Memorandum nuk sjell në asnjë mënyrë ndonjë të drejtë ose leje për t'u përdorur ose për t'u lidhur me pronën intelektuale të secilës Palë.

Neni 6. Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi, në datën e nënshkrimit dhe zgjat deri më 31. Tetor. 2028, datë kjo që përfaqëson edhe fundin e Projektit.

Neni 7. Përfundimi

Secila palë mund ta ndërpresë këtë bashkëpunim duke i dhënë palës tjetër, një njoftim tridhjetë (30) ditësh me shkrim. Në rast të ndërprerjes pjesore, njoftimi i tillë do të përcaktojë se cilat fusha të ndihmës janë prekur.

Neni 8. Gjuha

Ky Memorandum është përgatitur në tri origjinale, një në Gjuhën Angleze dhe dy në Gjuhën Shqipe. Autoriteti Zbatues do të marrë një original në Gjuhën Angleze dhe një në Gjuhën Shqipe ndërsa Komunitat Partnere do të marrë një original në Gjuhën Shqipe.

Neni 9. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje, paqartësi ose mospajtim që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i këtij Memorandumi do të zgjidhet, në radhë të parë, në mënyrë miqësore përmes konsultimeve dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

Në rast se Palët nuk arrijnë një zgjidhje të pranueshme përmes konsultimeve, ato do të vazhdojnë bashkëpunimin me mirëbesim, pa cenuar vazhdimësinë e aktiviteteve të Projektit.

Neni 10. Ndryshimet dhe amendamentet

Çdo ndryshim, plotësim ose amendament i këtij Memorandumi do të jetë i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.

Ndryshimet ose amendamentet e miratuara në këtë mënyrë do të bëhen pjesë përbërëse e këtij Memorandumi dhe do të kenë të njëjtën fuqi si dispozitat e tij origjinale.

Palët Nënshkruese:

Në emër të Autoritetit Zbatues:

Emri: Valentin Hoxha

Titulli: Drejtor i Projektit

Nënshkrimi:

Data: 25 Shkurt 2026



Në emër të Komunës Partnere

Emri: Imri Ahmeti

Titulli: Kryetar

Nënshkrimi:

Data: 25 Shkurt 2026



 QENDRA PËR ARSIM TË KOSOVËS (KEC) Qendra për Arsim të Kosovës Kosova Education Center			
PRANUAR MË: PRILJENI DANA: 24.02.2026			
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01-610/01-	9618		



MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT (MiM)

I LIDHUR NDËRMJET

QENDRËS PËR ARSIM TË KOSOVËS (KEC), SË BASHKU ME YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS (YAHR) DHE KOMUNËS SË E LIPJANIT

Ky Memorandum i Mirëkuptimit ("MiM") i lidhur në mes të Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) me lokacion në Kompleksin e shkollës Mileniumi i Tretë, rruga "Qëndresa", nr. 48, Prishtinë së bashku me Youth Association for Human Rights (YAHR), me lokacion rruga Tahir Sinani 14000 Lipjan dhe Komunës së Lipjanit, të gjithë tani e tutje të referuar si "Pjesëmarrësit".

Sfondi

KEC dhe YAHR zhvillojnë projektin rajonal e financuar nga BE "Iniciativa për Gjithëpërfshirje digjitale (DII)", që ka për qëllim forcimin e rolit të i OJQ-ve nga Ballkani Perëndimor në promovimin e demokracive pjesëmarrëse dhe procesin e përafrimit me BE-në, duke forcuar kapacitetet e tyre për zhvillimin e politikave dhe avokimin për përfshirjen digjitale. Përmes projektit DII synohet të avancohet përfshirja digjitale për grupet e marginalizuara në pesë vendet përfutuese të IPA-s, duke ndërtuar dhe shfrytëzuar partneritete kombëtare dhe rajonale që angazhohen aktivisht në avokimin e politikave, lehtësojnë dialogun konstruktiv me institucionet shtetërore dhe zbatojnë ndërhyrje pilot të targetuara dhe të matshme në nivel lokal për të rritur ndërgjegjësimin dhe promovuar politikën digjitale gjithëpërfshirëse.

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit

Ky MiM ka për qëllim vendosjen e një bashkëpunimi të strukturuar dhe afatmesëm ndërmjet palëve nënshkruese, me synim zhvillimin dhe zbatimin e përbashkët të aktiviteteve në fushën e arsimit, përfshirjes digjitale, fuqizimit të të rinjve, grave dhe komunitetit lokal në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Fusha e Bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në këto fusha:

- Zhvillimi dhe zbatimi i projektit edukative me qëllim gjithëpërfshirjes digjitale DII;
- Organizimi i trajnimeve, punëtorive, mentorimeve dhe aktiviteteve informuese për të rinjtë, gratë dhe grupet e cënueshme;



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



- Krijimi dhe funksionalizimi i hapësirave komunitare edukative dhe digjitale, për përdorim nga ana e qytetarëve të Lipjanit;
- Avokimi dhe dialogu institucional për politika lokale në fushën e arsimit, rinisë dhe transformim digjital;
- Shkëmbimi i ekspertizës, burimeve njerëzore dhe materiale në përputhje me kapacitetet e secilës palë.

Neni 3

Përgjegjësitë e Palëve

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) angazhohet që:

- Të ofrojë ekspertizë profesionale në fushën e arsimit dhe përfshirjes digjitale, si dhe zhvillimit të kapaciteteve;
- Të kontribuojë në hartimin e programeve trajnuese dhe metodologjive edukative, të organizuara nga YAHR;
- Të mbështesë iniciativat për gjithëpërfshirës digjitale dhe ngritjen e cilësisë së arsimit, të realizuara nga YAHR

Youth Association for Human Rights (YAHR) angazhohet që:

- Të koordinojë dhe zbatojë aktivitetet në nivel lokal;
- Të mobilizojë përfituesit dhe komunitetin lokal;
- Të sigurojë menaxhimin e përditshëm të aktiviteteve dhe raportimin përkatës.

Komuna e Lipjanit angazhohet që:

- Të mbështesë institucionalisht aktivitetet e përbashkëta;
- Të lehtësojë bashkëpunimin me institucionet publike lokale dhe shkollat;
- Të kontribuojë në qëndrueshmërinë e iniciativave në përputhje me politikat dhe planet strategjike komunale.

Neni 4

Koordinimi dhe Komunikimi

Takime koordinuese do të mbahen periodikisht, sipas nevojës, për të vlerësuar progresin dhe për të adresuar sfidat eventuale. Ky koordinim do të përfshijë korespondencë me shkrim dhe koordinim për të siguruar mbarëvajtjen e aktiviteteve.

Çdo njoftim apo komunikim tjetër formal i dhënë me këtë MiM do të zhvillohet me komunikim elektronik, t'i dorëzohet në dorë apo dërgohet me postë të parapaguar apo të regjistruar



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Pjesëmarrësit në adresën e përcaktuar të secilit Pjesëmarrës. Të gjitha kontaktet që mund të kërkohen nga Pjesëmarrësit për zbatimin e kushteve të këtij MiM-i do të drejtohen dhe kanalizohen përmes personit kontaktues të caktuar nga secili Pjesëmarrës si përfaqësues. Çdo Pjesëmarrës i këtij MiM-i duhet ta emërojë përfaqësuesin e saj. Këto emërimet duhet të mbahen aktuale gjatë periudhës së këtij MiM-i dhe emërimet mund të ndryshohen me komunikim direkt në pajtim me këtë paragraf.

Neni 5

Kohëzgjatja e Memorandumit

Ky MiM hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit për të gjithë Pjesëmarrësit dhe mbetet në fuqi deri në fund të projektit më 30 dhjetor 2027, apo përfundon më herët, nëse nuk vazhdohet me shkrim.

Neni 6

Ndryshimet dhe Përfundimi

Ky MiM mund të ndryshohet me njoftim me shkrim nga ana e Pjesëmarrësve. Cilido pjesëmarrës mund ta përfundojë pjesëmarrjen në këtë MiM duke u ofruar Pjesëmarrësit tjetër njoftimin me shkrim tridhjetë (30) ditë përpara

Neni 7

Pavarësia Publike e Pjesëmarrësve

Ky MiM do të zbatohet vetëm për aktivitetet që kanë të bëjnë me DII dhe vetëm për qëllimet e deklaruara në këtë MiM dhe në asnjë iniciativë të ndërmarrë aktualisht nga ndonjëri Pjesëmarrës bashkërisht apo ndarazi. Ky MiM nuk do të interpretohet në asnjë mënyrë si themelimi partneriteti, ndërmarrje e bashkuar apo ndonjë kombinim ose organizim tjetër ligjor midis Pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit do të konsiderohen si organizata të pavarura, dhe punonjësit, agjentët dhe zyrtarët e njërës nuk do të konsiderohen si punëtorë, agjentë apo zyrtarë të Pjesëmarrësit tjetër.

Neni 8

Shpenzimet

Të gjithë dhe secili Pjesëmarrës do të mbulojnë të gjitha shpenzimet që dalin nga Veprimet e tyre përkatëse të përcaktuara në këtë MiM; prandaj as njëri Pjesëmarrës, nuk do të mbulojnë shpenzime tjera apo marrin përsipër obligime tjera monetare që nuk janë të përcaktuara me këtë paragraf të MiM-it. Synohet që në asnjë mënyrë, ky MiM të mos konsiderohet, kuptohet apo interpretohet si kërkesë për ndonjërin nga Pjesëmarrësit për të bërë kontribute, donacione apo pagesa.

Pjesëmarrësit e kuptojnë që ky MiM nuk përbën obligim ligjor apo marrëveshje detyruese sipas ligjeve të Kosovës,.

Nënshkrimi



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Në shenjë dakordimi, palët nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi:

Për Palën

Emri & Pozita

Nënshkrimi Data

Kosova Education Center (KEC)

Honor Zylfian Haxhiu President 24.02.2026

Youth Association for Human Rights (YAHR)

Belum Krasniqi President 24.02.2026

Komuna e Lipjanit

Imri Ahmeti Kryetar 24.02.2026



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



01 Nr.Br. 550/01-7202

Data/Datum: 09-02-2026

Memorandum of Understanding

Between

The Embassy of UAE in Podgorica

Capital Plaza, Diplomatic Tower ,St. Shaikh Zayed , Podgorica-Phone: +382 204 114 36,
Email: podgoricaEMB@mofaic.gov.ae; hereinafter – **The Embassy**

And

The Municipality of (Lipjan) - hereinafter – The Municipality

Preface:

This Memorandum of Understanding (MOU) sets for the terms and understanding between the signing parties to distribute Humanitarian Food Parcels for needy people in the Municipality, whereas the donor is **Emirates Red Crescent**.

Background

This partnership is set to ensure the effectiveness of distribution of Food Parcels, to needy people without any discrimination.

Purpose:

In order to ensure effective, transparent and fairly distribution of humanitarian aid, the two parties have concluded this MoU on: ___/02/2026.

Principals of good practice:

This MoU shall be guided by the principles of good practice, including but not limited to:

- Abidance to the applicable laws and regulations of the Republic of Kosovo.
- Non-discrimination to the beneficiaries.
- Respect for the dignity of beneficiaries.
- Transparency.

Art.1

Commitments of the Embassy

1. Delivering to the site of Distribution, **(75)** Food Parcels, each contains:

No.	Item Description	Quantity, Kg;(L)
1	Wheat Flour	10
2	Rice	5
3	Sugar	5
4	Cooking Oil	5
5	Pasta / Macaroni	5
6	Beans (Dry)	3
7	Salt	1
	Total weight, Kg	34

Art.2
Distribution time table

Date	Day	Time	Site of Distribution	Food Parcel
13.02.2026	Friday	11:30		75

Art.3
Commitments of the Municipality

1. To prepare the list of beneficiaries, invite them and organize the distribution.
2. To secure official permissions, if required.
3. To notify security institutions, for keeping order during distribution (If required).
4. To issue a letter of thanks to the Donor (Emirates Red Crescent- Abu Dhabi - UAE), certifying the completion of the project.

Art.4
General Provisions

1. The Project Coordinators from the side of the Embassy, are:
 - a. Ibrahim Fadlalla, email: Ibrahim.fadlalla@gmail.com ; mob. +383 44 140 898
 - b. Miradije Salihu, email: miresalihu72@gmail.com ; mob. +383 49 650 212
2. The Project Coordinators, represents the Donors, and have the authorization to:
 - a. Coordinate and participate in the implementation of this MoU.
 - b. Set-Up Banners, stickers and hiring a Camera-Man for media covering, for the donor's documenting purpose, in UAE only.
 - c. This MoU enters into force from the date of signing by two parties, and remains in force until the fulfillment of commitments by each signing party.
3. The Municipality Field Coordinator:

Name & Surname, ALBERT MUSTAFA Job title: social care, health and welfare officer
Mob.: +383 44 558 960 email: albert.mustafa@rks-gov.net

Agreed and signed by both parties on: 09 /Feb/2026

The Embassy of UAE in Podgorica

Youssef Al Mazrouei




The Municipality of Lipjan

The Mayor

Imri Ahmeti





KOMUNA FUSHË KOSOVË
OPŠTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Kryetari i Komunës së Lipjanit dhe Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, bazuar në nenin 64 paragrafi 2 dhe nenin 65 paragrafët 2 dhe 5 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, si dhe në nenin 11 paragrafët 1 dhe 5 të Rregullores (QRK) nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Publikë, me datë **06.02.2026**, lidhin këtë:

MARRËVESHJE

për transferim të përhershëm për interes të institucionit

Palë të kësaj marrëveshjeje janë:

1. **Valon Prebreza**, Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës, dhe
2. **Imri Ahmeti**, Kryetar i Komunës së Lipjanit.

Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është transferimi i përhershëm i zyrtares **Esma Bajrami**, nga pozita **Specialiste e Mjekësisë Familjare** në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – QKMF Lipjan, në pozitën **Specialiste e Mjekësisë Familjare** në Komunën e Fushë Kosovës, Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – QKMF Fushë Kosovë.

Neni 2

Palët janë pajtuar që nëpunësja të transferohet në të njëjtën kategori në shërbimin publik, në përputhje me detyrat dhe obligimet që rrjedhin nga përshkrimi i detyrave të punës në pozitën e transferuar.

Neni 3

Palët janë dakorduar që transferimi i zyrtares nga Komuna e Lipjanit – Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – QKMF Lipjan, në Komunën e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – QKMF Fushë Kosovë, të realizohet duke filluar nga data **01.03.2026**.

Neni 4

Komuna e Lipjanit – Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore obligohet që të përcjellë dosjen personale të zyrtares **Esma Bajrami** në Komunën e Fushë Kosovës, për pozitën **Specialiste e Mjekësisë Familjare**.

Neni 5

Vendi i ri i punës është pozita **Specialiste e Mjekësisë Familjare**, me koeficient **13.00**, sipas Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Neni 6

Palët nënshkruese janë pajtuar që transferimi i nëpunëses të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Neni 7

Ky akt juridik është hartuar në katër (4) kopje identike, nga të cilat secila palë mban nga dy (2) kopje.

VALON PREBREG

Kryetar i Komunës së Lushë Kosovës



IMRI/ATIMETI

Kryetar i Komunës së Lipjanit





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANA:		02.02.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOS
14-	370/01-	5483	



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë :	02.02.2026
Referencë :	
Për:	Bekim Shabani drejtor i Prokurimit
Kopje:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës- Lipjan
Nëpërmjet :	Latif Ramadani, drejtor për Buxhet dhe Financa
Nga:	Shemsi Azemi, shef i sektorit të tatimit në prone
Lënda:	Shkrese përcjellëse e nënshkrimit të marrveshjes në mes PTK dhe Zyra e Kryetarit të Komunës




Përmes kësaj shkrese përcjellëse po ua përcjellim marrveshjen për printimin, zarfimin dhe shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë për vitin 2026, marrveshja e dates 30.01.2026 me nr të protokolit 01-168/26 në mes Zyrës së Kryetarit të Komunës z/Imri Ahmeti si Porositës i Shërbimeve dhe Posta e Kosoves si kryes i shërbimeve

Sipas analizave të bëra gjithsej fatura të printuara që pritet të prodhohen për ngarkesën e vitit **2026**, është përafërsisht **13,500- deri 13.900 fatura**.

Së bashku me këtë kërkesë po ua përcjelli kontratën në mes të Komunës së Lipjanit dhe të PTK-së.

PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošte Kosovo D.O.
Nr./No./Br. 01-168/26
Data/Date/Datum 30-01-2026
PRISTINE-PRISTINA-PRISTINA



KONTRATË PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE POSTARE (Shpërndarja e Faturave të Tatimit në Pronë)

E lidhur ndërmjet:

KRYESI I SHËRBIMEVE:

POSTA E KOSOVËS Sh.A. Adresa; Rr. 28 Nëntori, nr. 4, 10,000, Prishtinë, Republika e Kosovës. Me numër Unik Identifikues 811285205. E përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor znj. **Nora Rraci** - Kryeshefe Ekzekutive e PK SH.A., në tekstin e mëtejshëm :
Kryesi i Shërbimeve, dhe

POROSITËSI I SHËRBIMEVE:

KOMUNA E LIPJANIT, Adresa; rr. RR. SHQIPËRIA, R. Kosovës. E përfaqësuar nga përfaqësuesi Kryetari i Komunës së Lipjanit z/Imri Ahmeti, në tekstin e mëposhtëm :
Porositësi i Shërbimeve.

OBJEKTI I KONTRATËS:

Është printimi, zarfimi (me sigurimin e letrës dhe të zarfeve), si edhe shpërndarjen e dërgesave postare (faturave mbi tatimin në pronë të obliguesve tatimorë), në adresat e destinimit.

AFATI KOHOR:

Kontrata për Kryerjen e Shërbimeve fillon prej dt. **01/01/2026** dhe përfundon deri me dt. **31/12/2026**, dhe duhet të jetë e nënshkruar nga të dy palët që të ketë efekte kontraktuale.

Në bazë të kësaj kontrate, kryerësi i shërbimeve dhe porositësi i shërbimeve bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime

Në këtë Kontratë për kryerjen e shërbimeve, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përdorur kanë kuptimet e dhëna më poshtë:

KONTRATË : do të thotë kjo marrëveshje për kryerjen e shërbimit postar dhe me ndryshimet dhe plotësimet eventuale sipas nenit 4.2;

KRYERËSI I SHËRBIMEVE : do të thotë: Posta e Kosovës SH.A., e cila do të bëjë shpërndarjen e dërgesave postare (Faturave të Tatimit në Pronë) në adresat e destinimit.

POROSITËSI I SHËRBIMEVE : do të thotë: Komuna e Lipjanit.

AFAT : ka kuptimin e kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.

TARIFA POSTARE : ka kuptimin e Listës së Çmimeve të Shërbimeve Postare sipas ofertës, dhe është e inkuorporuar në këtë kontratë.

OBJEKTE POSTARE : ka kuptimin e dërgesave që nënkupton të gjitha shërbimet që kryen kryerësi i shërbimeve;

PERSONI KONTAKTUES : ka kuptimin e personit, me të cilin bëhen kontaktet në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate;

PRINTIMI I FATURAVE : nënkupton printimi i faturave të obliguesve tatimore në bazë të shënimeve të marra nga baza e të dhënave nga MEF-i;

IT & POSTA HIBRIDE : do të thotë Departamenti i PK Sh.A., i cili kryen përgatitjen, printimin e faturave dhe zarfimin e tyre;

ZARFIMI : nënkupton futjen e faturave në zarfe dhe përgatitja për shpërndarje.

Neni 2

Detyrimet e Palëve

2.1. Kryerësi i Shërbimeve, do të bëjë Printimin, Zarfimin (*dhe sigurimin e letrës dhe të zarfeve*) dhe Shpërndarjen e dërgesave postare/faturave mbi tatimin në pronë të obliguesve tatimor, në adresat e destinimit, të zgjedhur nga porositësi i shërbimit për mënyrën (Thjesht apo Rekomandë) e shpërndarjes, e cila ofertë është e inkuorporuar në këtë kontratë në nenin 3.4.

2.2. Kryesi i shërbimeve, detyrohet të bëjë pranimin e shënimeve nga baza e të dhënave të porositësit të shërbimeve dhe të njëjtat shënime do të futen në faturat përkatëse, me të cilat bëhet faturimi i tatimit, në pronë i detyrimeve tatimore, mandej do të bëhet printimi i faturave në fjalë, zarfimi dhe pastaj shpërndarja e tyre deri te adresa e tatimpaguesit.

Në këtë mënyre faturat e gatshme të përgatitura për shpërndarje nga kryesi i shërbimeve (TI/PH) kalojnë tek Drejtoria Operative PK Sh.A. sipas Regjioneve për shpërndarje të tyre në adresat e destinimit.

2.3. Kryesi i shërbimit, për shërbimet e kryera, përgatit faturat për pagesë për Komunën e Lartcekur. Paga e këtyre faturave, duhet të bëhet në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga përfundimi i shërbimit .

2.4. Faturat e përgatitura nga kryesi i shërbimit, do t'i dorëzohen Komunës në fjalë – si Porositës i Shërbimit .

2.5. Kryerësi i shërbimeve, duhet të njoftojë porositësin e shërbimeve, mbi shpërndarjen e faturave në fjalë (numrat dhe datat për secilën komunë) dhe për faturat e humbura gjatë printimit, në rast se ndodh kjo.

2.6. Kryesi i shërbimit, duhet të përfundojë printimin, zarfimin, shërbimet përcjellëse postare dhe shpërndarjen e të gjitha faturave tatimore për vitin 2026, në afatin e paraparë ligjor. Në rast të kërkesës, për shërbim shtesë ose ndryshim shërbimi gjatë vitit 2026, detajet përkufizohen në një shkresë të veçantë me shkrim, me miratimin e palëve, si aneks i kësaj kontrate.

2.7. Porositësi i shërbimit, detyrohet që kryesin e shërbimit (PK Sh.A.) ta furnizoj me të gjitha shënimet bazë të të gjithë obliguesve tatimorë, për të cilat duhet të përgatiten faturat për tatim në pronë dhe që pas përgatitjes, do të shpërndahen nga kryesi i shërbimeve.

2.8. Kryesi i Shërbimeve PK SH.A., zotohet se printim, zarfimi dhe shpërndarja do të bëhet në afatet e parapara me këtë Kontratë.

2.9. Kryesi i Shërbimeve PK SH.A. nuk mban përgjegjësi në rast se porositësi i shërbimeve nuk i saktëson adresat, për faturat e tatimit në pronë, ato me adresa gjysmake apo faturat fare pa adresa në këto raste për faturat e shtypura pagesa duhet të kryhet nga porositësi i shërbimeve njësoj sikur edhe për faturat e shpërndara.

Neni 3

Kushtet e Pagesës

3.1. Kryesi i shërbimeve për shërbimet e bëra nga neni paraprak i kësaj kontrate përmes faturës ja faturon shërbimet e bëra porositësit të shërbimit, sipas ofertës së zgjedhur nga porositësi i shërbimit. Faturat do të tarifohen në emër të Komunës përkatëse dhe ato i dorëzohen direkt atyre.

3.2. Në rastet ku gjatë afatit kontraktues, me ndonjë vendim institucional nga rregullatori apo operatori publik, ka ndryshim të tarifave të shërbimeve postare (shpërndarjes), konsumatori obligohet që të paguaj faturat sipas tarifave të ndryshuara.

3.3. Porositësi i shërbimit obligohet që pagesën për takson postare dhe shërbimin e kryer të bëjë në llogarinë bankare të Postës së Kosovës SH.A. sipas faturës së dorëzuar, në afat ligjor prej 30 ditëve me shenjen për të hyrat e "Posta e Kosovës SH.A.", nëse pagesa nuk kryhet pas afatit ligjor prej 30 ditëve, Kryesi i shërbimeve mund t'ja ndërprerje shërbimet postare dhe inicioj procedurat përmbarimore.

3.4. Kryesi i Shërbimit për shërbimet e bëra; printim, zarfim, dhe shpërndarje të këtyre dërgesave i faturon porositësit të shërbimit me çmimin sipas ofertave të paraqitura në si më poshtë:

Oferta përfshin Shërbimin e letër dërgesave të Thjeshta(Thj), dhe Rekomande(R).

SHERBIMI I LETËRDËRGESË SË THJESHT (pa regjistruar).

Shërbimi Letër e thjeshtë, është shërbim i cili bën pjesë në shërbimet e zakonshme të postës vendore dhe ndërkombëtare. Janë dërgesa postare të pa regjistruara, për të cilat me rastin e pranimit, dërguesit nuk i lëshohet vërtetimi mbi pranimin e dërgesës, ndërsa me rastin e dorëzimit nga marrësi nuk kërkohet të vërtetojë pranimin e saj.

Tabela 1:

Çmimi për dërgesë (TATIMI NË PRONË) me peshë deri 50 gr. deri në dy faqe

Letërdërgesat postare të thjeshta "THJ" trafiku vendor

*Oferta përfshinë : Letrën A4 (shtypjen bardh e zi); Zarfin C5 deri në 5 fletë dhe C4 për dërgesë mbi 5 fletë; Thyerjen dhe zarfimin për çdo dërgesë; Shpërndarjen e dërgesave sipas shërbimit të përzgjedhur: Letër dërgese e thjeshte "THJ".

Çmimi për dërgesë (TATIMI NË PRONË) me peshë deri 50 gr. Deri në dy faqe Letërdërgesat postare të thjeshta "THJ" trafiku vendor	
Letra dhe shtypja – bardh e zi	0.045
Zarfi	0.10
Palosja	0.060
Personalizimi	0.065
Shpërndarja e thjeshtë me peshë deri 50 gr.	0.50
Totali	0.77€

Dërgesat me më shumë se dy faqe, i referohet tarifave në tabelën e më poshtme:

Tabela 2 :

Letër dërgesat postare të thjeshta "THJ" trafiku vendor

Nr.	Përshkrimi i artikullit: lloji i shërbimit	Pesha gr	Shtypja A4 bardh/zi çmimi rritet për çdo faqe shtesë	Faqe	Zarf C5 përdoret për dërgesa deri në 4 fleta ndërsa C4 për dërgesat me mbi 5 fletë	Thyerje dhe zarfim për një dërgesë	Total printimi sipas faqeve	Personalizim m për faqe	Gjithsejtë	Shërbimi i dërgesës Thjeshtë THJ	Çmimi total për njësi (€)
1	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	deri 50 gr.	0.045	3	0.10	0.060	0.135	0.065	0.360	0.50	0.860
2	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	mbi 50-100	0.045	8	0.10	0.060	0.36	0.065	0.585	0.60	1.185
3	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	mbi 100-250	0.045	45	0.10	0.060	2.025	0.065	2.250	0.80	3.050
4	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	mbi 250-500	0.045	95	0.10	0.060	4.275	0.065	4.500	1.20	5.700
5	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	mbi 500-1000	0.045	195	0.10	0.060	8.775	0.065	9.000	1.50	10.500
6	Dërgesa e thjeshtë THJ (bardh e zi)	mbi 1000-2000	0.045	395	0.10	0.060	17.775	0.065	18.000	2.50	20.500

Tabela 3 :

Numri i përafërt i fletëve dhe zarfi

Pesha gr	Numri i përafërt i fletëve dhe zarfi (13gr)
deri 50	Deri 7 copë + zarfi A5
51-100	Deri 19 copë + zarfi A4
101-250	Deri 51 copë + zarfi A4
251-500	Deri 106 copë + zarfi A4
500-1000	Deri 215 copë + zarfi A4
1000-2000	Mbi 215 copë (max deri 2kg.) A4

Te gjitha çmimet janë me TVSH

SHËRBIMI LETËRDËRGESË E REGJISTRUAR/REKOMANDE (R)

Shërbimi letër dërgesë e regjistruar/rekomandë (R), është shërbim i cili bën pjesë në shërbimet e veçanta të postës vendore dhe ndërkombëtare. Është dërgesë postare e regjistruar, për të cilën me rastin e pranimit, dërguesit i lëshohet vërtetimi mbi pranimin e dërgesës, ndërsa me rastin e dorëzimit nga marrësi kërkohet të vërtetojë pranimin e saj.

Në këtë ofertë po ju paraqesim tarifat për shërbimin letër dërgesë e regjistruar/rekomandë (R) brenda territorit të Kosovës. Oferta përfshin komplet procesin e përpunimit dhe të shpërndarjes së dërgesave/faturave të tatimit në pronë, por tarifohet vetëm shpërndarja si letër dërgesë e regjistruar/rekomandë (R).

Nr.	Pesha gr	Shërbimi i dërgesës rekomande "R"
1	deri 50 gr.	1.10
2	mbi 50-100	1.20
3	mbi 100-250	1.40
4	mbi 250-500	1.80
5	mbi 500-1000	2.10
6	mbi 1000-2000	3.10

Te gjitha çmimet janë me TVSH

PËRFSHIRJA NË MARRËVESHJEN MPB/MAPL PËR SHËRBIMIN ME Rekomande(R)

Për ofertën/shërbimin e shpërndarjes së dërgesave me Rekomande(R), porositi i shërbimit mund të shfrytëzoni marrëveshjen mbi ofrimin shërbimeve postare për Institucionet e Republikës së Kosovës (IRK) të nënshkruar në mes të Postës e Kosovës Sh.A., Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal (MAPL), si përfaqësuese të Institucioneve Qeveritare.

Kjo marrëveshje përcakton kushtet, çmimet për njësi dhe rregullat e zbatimit për realizimin e shërbimeve postare për Institucionet e Republikës së Kosovës.

Përfituesit/Porositësi i shërbimit nga kjo marrëveshje obligohen që të dërgojnë në Postën e Kosovës Sh.A., konfirmimet në formë të shkruar/email, të cilat do të jenë bazë për faturim për secilin Institucion i R. Kosovës.

Neni 4

Ndryshimi i Kontratës

4.1. Kjo kontratë, do të mbetet në fuqi dhe do të jete e vlefshme në çdo rast transferimi ose kalimi.

4.2. Ndryshimet në këtë Kontratë, duhet të bëhen vetëm me shkrim, me nënshkrime të Përfaqësuesve të Autorizuar, ose pasardhësve të tyre, me autorizim të Titullarëve të Institucioneve respektive, për çdo rast.

4.3. Çdo çështje e pa trajtuar në këtë Kontratë, do të zgjidhet me pajtimin dhe shqyrtimin e palëve kontraktuese në përputhje me Ligjin „Mbi Shërbimet Postare”.

Neni 5

Përgjegjësitë

5.1. Kryesi i Shërbimeve, është përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar në pajisjet për shkak të akteve ose mosveprimeve të tij, nga pakujdesia, keq shfrytëzimi ose keqpërdorimi prej personelit të tij, qoftë ky i prekshëm ose i paprekshëm, në secilin prej rasteve të lartpërmendura, të cilat ndodhin gjatë përmbushjes ose në lidhje me përmbushjen e kësaj Kontrate.

5.2. Çdo dërgesë postare që është objekt reklamacioni do të trajtohet sipas ligjeve

dhe akteve nënligjore që janë në fuqi në kohën e paraqitjes së reklamacionit.

5.3. Kryesi i Shërbimeve, nuk mban përgjegjësi nëse këto janë të natyrës që përshkruhet në Nenin 6 (Forcë Madhore).

Neni 6

Forca Madhore

6.1. Nëse, në çdo kohë, gjatë afatit kohor, të përcaktuar në këtë Kontratë, përmbushja plotësisht ose pjesërisht nga secila Palë, e çdo detyrimi sipas kësaj Kontrate, pengohet ose vonohet për shkak të luftës, luftës civile, armiqësisë, akteve të armikut publik, rebelimit, revolucionit, fuqisë ushtarake ose të uzurpimit, shqetësimeve civile, demonstratave ose kërcënimeve të menjëhershme lidhur me gjithë sa më lart, sabotazhit, zjarrit, përmbytjes, shpërthimeve, pandemive, epidemive, kufizimeve për shkak të karantinës, shqetësimeve në furnizime nga burime normalisht të besueshme (ku përfshihen por jo vetëm elektricitet, ujë, naftë dhe të ngjashme), greva, përjashtime, vendime qeveritare ose ndonjë ngjarje tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës në fjalë (këtu e më poshtë e përmendur si “ndodhia”), atëherë përmbushja e këtyre detyrimeve do të falet në masën që u pengua ose u vonua dhe pala e prekur ka marrë njoftim për këtë ndodhi, nga Pala tjetër brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e ndodhisë, duke pasur parasysh që ngjarja e çdo ndodhie, nuk justifikon asnjë detyrim të secilës Palë për të kryer pagesa.

6.2. Asnjëra Palë, për shkak të ndodhisë, nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë ose të ngrejë pretendime për dëme kundër palës tjetër, në lidhje me mos përmbushjen ose vonesën në përmbushje. Përmbushja e detyrimeve të cenuara, duhet të rifillojë sapo të jetë praktike pas përfundimit ose pushimit të ndodhisë në fjalë.

6.3. Nëse përmbushja tërësisht ose pjesërisht e ndonjë detyrimi sipas kësaj kontrate vonohet për shkak të ndonjë ndodhie të tillë, për një periudhë që tejkalon 3 (tre) muaj, Palët do të takohen dhe rishikojnë në mirëbesim dëshirueshmërinë dhe kushtet për zgjidhjen e Kontratës.

Neni 7

Marrëveshja e Plotë

7.1. Palët bien dakord se marrëveshja dhe mirëkuptimi në mes tyre, përfundon prej datës efektive të kësaj kontrate, me kusht që, të gjitha shumat që përbëjnë detyrim ndaj secilës Palë, sipas marrëveshjes së mëparshme, mbeten ende detyrime dhe të pagueshme.

Neni 8

Zgjidhja e Kontratës

8.1. Kontrata fillon efektet ligjore me nënshkrimin nga të dyja palët dhe përfundon deri 31.12.2026, me mundësi vazhdimi edhe për një (1) vit tjetër.

8.2. Para përfundimit të afatit të Kontratës, 30 ditë, palët duhet të shqyrtojnë mundësinë e vazhimit të kontratës dhe bashkëpunimit, me kërkesën paraprake me

shkrim për vazhdim dhe në rast nevojë ndryshim shërbimi të kërkuar nga ana e porositësit të shërbimit.

8.3. Zgjidhja e kontratës është e mundur edhe nëse dispozitat ligjore mbi shërbimet postare e parashohin një mundësi të tillë.

Neni 9 Përfaqësuesit

9.1. Për Kryesin e Shërbimit - PK Sh. A, Personi Kontaktues do të jetë znj. **Vlora Thaqi** – zyrtare e shitjes në PK Sh.A, email: vlora.thaqi@postakosoves.com, zyrtare përgjegjëse për përcjelljen, kujdesin dhe menaxhimin e zbatimi të kontratës, me nr. tel; +383(0)44587875, apo nga **Shitja - PK Sh.A**, nr. tel; 038534478.

Për Porositësin e Shërbimit: **Shemsi Azemi**, numër kontaktues tel. +383200-41545, dhe email: shemsi.sh.azemi@rks-gov.net

Neni 10

Ligji dhe Juridiksioni

10.1. Në rast të çdo mosmarrëveshjeje, që lind për shkak ose në lidhje me përmbushjen ose interpretimin e kësaj kontrate, Palët, bien dakord të takohen dhe të negociojnë në mirëbesim, për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të së cilës, vendimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes, do ta marrë Gjykata kompetente e Prishtinës.

10.2. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje lidhur me versionin, versioni në gjuhën Shqipe do të mbizotërojë.

10.3. Kjo Kontratë hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale, për të dy (2) Palët nga 1 (një) kopje origjinale, dhe një (1) kopje për Departamentin e Tatimit në Pronë.

PËR DHE NË EMËR
TË KRYESIT TË SHERBIMEVE

znj. **Nora Rraci**,
Kryeshefe Ekzekutive e PK, SH.A.

Data:

30/01/2026

PËR DHE NË EMËR
TË POROSITESIT TË SHERBIMEVE

z/**Imri Ahmeti**

Kryetari i Komunës :

Data:

22/01/2026